

LENA MANDA
THEANOJA, UJKONJA E STAMBOLLIT
ROMAN

BOTIMET TOENA

LENA MANDA

Theanoja,
ujkonja e Stambollit

roman

Përktheu nga origjinali greqisht
Kristo Pulla

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Autorja: Λένα Μαντά (Lena Manda)
Titulli në original: Θεανώ, η λύκαινα της Πόλης
Botoi në greqisht: Psychogios

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Albina Pulla
Korrektore letrare: Arlinda Rrushli
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Albana Kura Gega

ISBN 978-9928-235-62-6

© 2006 Psychogios Publications S.A.

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Pak fjalë prej meje

Kam parë njerëz që kur fillojnë një libër, lënë pa lexuar hyrjen apo ndonjë shënim të shkrimtarit dhe vazhdojnë me subjektin e veprës.

Këtë gjë nuk e kam kuptuar kurrë.

Shënimi i shkrimtarit më intereson gjithnjë, sepse, nëse në libër flasin personazhet, te shënimi flet shkrimtari dhe unë dëshiroj të di se çfarë ka për të më thënë.

Unë, nga ana ime, do të kisha shumë për të thënë për librin që po mbani në duar.

Kam lindur në Stamboll dhe aty kalova pesë vitet e para të jetës sime. Siç është e natyrshme, pak gjëra mbaj mend...

Viti kur unë kam lindur, ishte viti i dëbimeve. Natyrisht që unë nuk kuptoja asgjë...

Por, Stambolli është një qytet unik dhe, me sa duket, zotëron aftësinë magjike që të bëhet njësh me trupin e gjithsecilit, sadopak që ky mund të ketë jetuar aty, sado të pakta të jenë kujtimet për bukurinë dhe sharmin e tij. Sigurisht që kjo vlen shumë më tepër për të gjithë ata që kaluan aty gjysmën e jetës së tyre...

E konstatova këtë gjë kur fillova të pyes më të mëdhenjtë në moshë, kur u kërkova që t'u jepnin jetë kujtimeve të tyre për kohën që jetuan aty, në përpjekje për të mbledhur informacione për librin tim.

Nuk e pata aspak të vështirë t'i bindja të më flisnin jo vetëm për çastet e bukura që kishin kaluar në atdheun e tyre të largët, gjë e cila do të ishte e pranueshme, por edhe për momentet e këqija...

Natyrisht që, së pari, fillova me familjen time.

Me xhaxhain tim, Taqin, dhe gruan e tij, Ketin, me Stelion dhe atë shprehjen e paimitueshme që më tha: “Turqit duhet të vdesin dhjetë e nga dhjetë përditë, dhe njëqind në javë, më thoshte nëna... ”.

Me tim atë dhe me Klionë, që më përshkruan të gjitha ato që përjetuan në Stamboll, dhe veçanërisht atë natë të vitit 1955, ashtu siç e përjetoi secili prej tyre...

I falënderoj të gjithë, sepse të gjithë ishin shumë të saktë në përshkrimet e tyre.

Por, mbi të gjithë, dëshiroj të falënderoj nënën time, sepse u tregua një ndihmëse e çmuar. Madje ia doli të vizatonte edhe hartën e Stambollit, që të “orientohesha” në një qytet që nuk e njihja... M'i shqiptonte me mijëra herë në rrokje fjalët e panjohura për mua, që në një moment i përdornin personazhet e mia dhe korrigjoi të gjitha gabimet e gjuhës greke që ata flisnin në “dialektin e Stambollit”.

Kur mbarova me të afërmit, iu drejtova internetit. Më duheshin data, emra, ngjarje, dhe vetëm aty mund t'i gjeja. U mundova orë të panumërta dhe më duhet të pranoj se teknologjia nuk është nga pikat e mia të forta.

Lexova të gjithë librat që gjeta dhe që trajtonin atë temë, dhe arrita deri te Shoqata e Kostandinopojësve për të gjetur

veprën *Thavma - Mrekullia* të Leonidha Kumakit, të cilën e lexova brenda një nate...

Është tepër e vështirë të shkruash për diçka të cilën, në thelb, nuk e njeh, por besoj se ia arrita ta bëj saktë.

Por, jua theksoj, se ky libër nuk është libër historik.

Ngjarjet historike që përmenden në libër përbëjnë vetëm kuadrin që i duhej fantazisë sime brenda të cilit vendosa Theanonë, Argjirin, Dhespinën dhe të gjitha personazhet e tjera.

Ajo natë e vitit 1955, të cilën unë përshkruaj në vepër, sigurisht që përmban disa nga historitë që më treguan të afërmit e mi, sepse me të vërtetë disa turq shpëtuan shtëpinë e Klios duke thënë gënjeshtër, ashtu siç ishte turk edhe ndihmësi i babait tim, që i tha të largohej për të parë se si i kishte familjarët dhe t'i ndihmonte nëse mundej.

Por turq ishin edhe ata që shkatërruan thertoren e gjyshit tim dhe me një të rënë të sëpatës prishën frigoriferin e madh, turq ishin edhe ata që rrafshuan dyqanin e gjyshit tim tjetër...

Për fat të mirë, asnjë prej anëtarëve të familjes sime nuk pati fatin e Theanosë...

Dhe në fund, falënderimin më të madh e ruajta për të gjithë ju që mbani këtë libër në duart tuaja dhe e përzgjodhët për t'ju bërë shoqëri...

LENA MANDA

KAPITULLI 1

(Dhjetëvjeçari i parë, 1935-1945)

Llambat me vajguri ndriçonin dhomën duke krijuar hije në ambientin e madh ku ndodhej krevati i stërmadh dopio, zbukuruar me qëndisma përreth dhe sipër te mbulesa. Dhespina psherëtiu dhe e mbështeti përsëri kokën në jastëk e mbuluar në djersë. Gruaja e kunatit të saj, Urania, nxitoi t'ia lehtësonte gjendjen, duke i vendosur mbi ballë një peshqir të lagur me ujë të ftohtë.

- Kurajë, e dashur, - i tha me ëmbëlsi, - vuajtjet po mbarojnë! Nesër nuk do të të kujtohet më asgjë!

- Ka të drejtë! - ra dakord me të edhe mamia, e cila, e përkulur te këmbët e poshtme të krevatit, po ndiqte procesin e lindjes. - Për momentin, gjithçka po shkon për së mbari!

- Kam dhimbje... - mermëriti Dhespina. - Kam shumë dhimbje... Më duket sikur do të më thyhet mesi!

- Po mbarojmë... Tani që do të vijnë dhimbjet e forta, mos iu shmang! - e urdhëroi mamia. - Përtype dhimbjen! Përtype dhe jepi një të shtyrë që të dalë fëmija!

Me aq fuqi sa i kishte mbetur, Dhespina bëri siç i tha mamia. Theanoja, fëmija i saj i parë, erdhi në jetë vetëm pak orë pasi kishte mbërritur Viti i Ri. Ishin mbledhur të gjithë për të festuar ardhjen e Vitit të Ri kur Dhëspinën e zunë dhimbjet e lindjes. Tryeza e Vitit të Ri mbeti përgjysmë, në shtëpi u bë rrëmujë dhe u thirr me urgjencë mamia, e cila filloi menjëherë punën; dy burrat prisnin në dhomën e

ndenjjes duke dëgjuar britmat e Dhespinës, që herë pas here ishin të tilla që të lëndonin në shpirt.

Josifi ishte martuar me Dhespinën pothuajse para dy vjetësh dhe banonin në shtëpinë dykatëshe të prindërve së bashku me vëllain e tij, Theofilin, dhe bashkëshorten e tij, Uraninë.

Këtë shtëpi e kishin trashëguar nga babai i tyre, së bashku me katër dyqane, si dhe një shtëpi tjetër që ia jepnin me qira turqve. Familja e Josifit dhe e Theofilit ishte e pasur, por edhe dy vëllezërit kishin sukses falë punës së tyre. Josifi kishte një dyqan për shitje vezësh në *Bejazit sokak*, ndërsa pranë tij, Theofili kishte hapur dyqan mishi. Shtëpinë e kishin vetëm pak metra më tutje.

Si Urania që u martua e para, ashtu edhe Dhespina që u martua pas saj, megjithëse që të dyja kishin pajën e tyre, konsideroheshin me shumë fat që u martuan me vëllezërit Jumurtaxhi. Të rritura në *Xhihangjir*, një lagje që konsiderohej si aristokratike, sipas standardeve që përcaktoheshin prej vendit dhe kohës, ato ishin mikështa para se të bëheshin kunata.

Shtëpitë e tyre, e Dhespinës, që gjendej në katin e parë, dhe e Uranisë në katin e dytë, kishin po atë planimetri dhe pothuajse të njëjtin mobilim. Dhomë ndenjjeje të madhe, dhomë të madhe ngrënieje, dy dhoma gjumi dhe një kuzhinë të mbushur me tenxhere, tiganë, tepsi dhe të gjitha enët që përdornin dy zonjat e shtëpisë për të ushqyer familjet, por edhe veten e tyre.

Një garë e fisme zhvillohej mes tyre për atë se kush do të gatonte gjellët më të shijshme, dhe sidomos cila do të përgatiste glikonë më të mirë. Më vonë, Theanoja do të kujtonte nënën e saj, me një pamje si të atyre që provonin

privilegjet e fronit, që para se të shuante zjarrin, hidhte një pikë nga shurupi i glikosë mbi thoin e saj dhe e linte të kullonte. Nga kjo pikë varej nëse pamja e saj e vrazhdë do t'ia lëshonte vendin buzëqeshjes së suksesit. Duhej që pika të qëndronte si një perlë e shndritshme mbi thoin e saj, në të kundërt, nëse pika rrëshqiste, do të thoshte se glikoja nuk ishte “lidhur” si duhej. Dhe atëherë Dhespina e stimulonte zjarrin, frynte dhe shfrynte sipër tij, derisa glikoja të lidhej aq sa duhej.

Te rafti mbi mbajtësen e pjatave radhiste kavanozat me të gjitha reçelet. Sepse çdo stinë kishte dhe reçelin e saj, që duhej të përgatitej. Të njëjtën gjë bënte edhe Urania. Pastaj të dyja i provonin dhe bënë kritika për reçelin e njëra-tjetrës, por gjithnjë me mirësjellje dhe dashuri.

Në këtë komunitet të vogël, në të gdhirë të Vitit të Ri, erdhi në jetë Theanoja. Gruaja e xhaxhait të saj doli e gëzuar nga dhoma për t'u dhënë lajmin e gëzueshëm dy vëllezërve.

- Të na rrojë! Është vajzë! - tha ajo dhe përqafoi kunatin e saj, i cili ishte i emocionuar.

Josifi nuk e kishte problem që nuk kishte lindur djalë. Donte vajzë, që t'i vinte emrin e nënës, e cila u kishte vdekur kur ishin ende fëmijë. Për më tepër, i ati i tyre kishte arritur ta dëgjonte emrin e tij nga Theofili, që vitin e kaluar, në këtë kohë, ishte bërë me djalë. Argjirin, i cili prej shumë orësh flinte në dhomën përbri.

Pak muaj pas lindjes së djalit të parë të familjes, kishte ikur nga kjo botë edhe i ati i tyre, nga zemra. Por Theanoja atëherë nuk dinte asgjë nga të gjitha këto. Pas torturave të lindjes, po flinte në djepin e saj të stolitur, tek ai djep ku e ëma kishte harxhuar orë të panumërta, duke qëndisur dhe duke thurur dantella, derisa më në fund e pranoi edhe vetë

se e kishte tepruar. Sigurisht që nuk dinte se kishte lindur në qytetin më të bukur, më të mrekullueshëm të botës, i cili njihej edhe thjesht si... Qyteti, Poli, por që kishte edhe emra të tjerë... Bizanti... Kryeqyteti i Perandorisë Bizantine.

Kostandinopojë ishte emri i tij zyrtar. Istanbul për turqit, të cilët përpiqeshin të harronin se cili ishte ai qytet dhe mënyrën se si e kishin pushtuar dhe, ndërkohë, nuk mundeshin të pranonin se nuk do t'u përkiste kurrë...

Sado që e zbukuruan me minare dhe me xhami, sado që u munduan të zhdoknin çdo gjë që u kujtonte prejardhjen e tij bizantine, nuk mundën të shkulnin zemrën e tij, atë zemër që ishte greke dhe rrihte sipas ritmit të dikurshëm të kabanave të shën Sofisë...

Kishte edhe një emër tjetër ai qytet... Mbretëror... Dhe ishte i tillë... Prandaj dhe i faleshin të gjithë popujt. Sepse kur je përballë një mbretëreshe, përkulesh dhe falesh... Sidoqoftë, me çfarëdo emri që ta quash, një është, Kostandinopoja, Konstandinupoli, Poli... Një qytet i mistershëm dhe që shfaqej nga shkulpturat e detit me një tyl të mëndafshhtë për të mbuluar lakuriqësinë, por edhe plagët e tij të panumërta. E plagosën, e gjakosën, i shkaktuan dhimbje, por ai qytet i lante plagët e tij në tri detet që e rrethonin dhe e ledhatonin, dhe ngrihej përsëri në këmbë. Në një dorë ai mbante Perëndimin, dhe dorën tjetër... dorën tjetër ia mbante peng Lindja. I ulur si në një fron, në shtatë kodrinat mbi të cilat ishte ndërtuar, vështronte kombet që jetonin në prehrin e tij. Në këtë *Polin* pra, që ishte një dhe i vetëm, që i njëjtë me të as ka ekzistuar dhe as që do të ekzistojë, lindi Theanoja.



Dhespina, sipas traditës, për dyzet ditë nuk doli nga shtëpia, megjithëse kur u mbushën njëzet ditë ajo vajti në kishë për t'u bekuar. Urania, si një nënë me eksperiencë, sepse kishte edhe vetë foshnjë, i qëndronte në krah si ndihmëse dhe këshilltare e çmuar. Theanoja rezultoi një foshnjë e mbarë. Nuk qante pothuajse kurrë, por ishte këmbëngulëse kur vinte koha për të ngrënë. Kur nëna e saj e vendoste në djep, të ushqyer e të ndërruar, ajo rrinte urtë dhe nuk ndihej, madje edhe kur nuk flinte.

Kushëriri i saj i vogël, Argjiri, ishte krijesa e vetme që dukej se i interesonte që në momentin e parë kur mundi të shquante fytyra, por edhe ai tregonte një dobësi të veçantë për atë krijesë të vockël me flokë të rrallë, me sy të mëdhenj dhe shprehës.

Theanoja i ngjante së ëmës. Kishte lëkurë të bardhë, flokë gështenjë të errët dhe sy të zinj si ullinj. Ajo që të gënjente te Theanoja, ishin buzët e saj. Të vogla, të rrumbullakëta, që ngjanin si një fjongo e vogël, duke të dhënë përshtypjen se para teje qëndronte një vajzë e ëmbël dhe e dëgjueshme. Por Theanoja ishte e kundërta. Që e vogël kishte pikëpamjet e veta, ishte kokëfortë dhe autoritare, dhe nuk ta përtonte në përgjigjet që të jepte.

- Kujt i ka ngjarë kjo vajzë? - pyeste veten Dhespina e dëshpëruar shumë herë me këmbënguljen që tregonte e bija.

- Vetes sime! - i përgjigjej Theanoja kur u rrit, teksa e dëgjonte të ankohej.

Pika e dobët e vajzës së saj të parë ishin ëmbëlsirat. Megjithëse Dhespina i fshihte mbi mbajtësen e enëve, Theanoja në një mënyrë të habitshme gjithmonë i arrinte

dhe i zhdukte. Sidomos reçelin prej trëndafil. Petalet e trëndafilin që notonin në shurup, i pëlqenin tej mase. Dhe që të mos dallohej prej së largu që kavanozi po zbrazej, vogëlushja e rafinuar përdorte një karficë flokësh që të merrte vetëm reçelin, pa e prekur shurupin.

Duhej të ishte rreth dhjetë vjeçe kur bëri një gabim kaq të madh, sa që nga e rrahura e së ëmës, lemza nuk i pushoi dy ditë me radhë nga të qarët. Ishte ditë e enjte dhe çdo të enjte Dhespina priste në shtëpi mikeshat e saj. Ishte një traditë e kohës, kur telefoni konsiderohej ende një luks i tepërt. Zonjat kishin një ditë të caktuar kur njoftonin se shtëpia e tyre ishte e hapur për miket e tyre dhe të afërmet, kështu që ishin organizuar në mënyrë të tillë sa që asnjë prej punëve të mos mbetej e pambaruar. Dhespina, që kur ishte martuar, kishte caktuar të enjten si ditë pritjeje, dhe atë ditë veçanërisht ishte shumë e gëzuar. Kishte vite që glikoja e trëndafilin nuk i bëhej aq i mirë sa këtë herë, dhe synonte që t'i binte në sy asaj Julisë, që mburrej për glikotë e saj, a thua se asnjë tjetër nuk dinte të përgatiste gliko, dhe që i trulloste të gjitha çdo të premtë që ajo kishte pritje, me hollësi se si i kishte përgatitur, pavarësisht nëse e pyeste kush apo jo!

Shtëpia, si gjithmonë, shkëlqente nga pastërtia, në bufe shndrisnin shandanët prej argjendi të gjyshes së saj si dhe kupa prej kristali që përdorej për qerasje, dhuratë e xhaxha Moisiut për dasmën e saj, të cilën e admironin të gjithë, ngaqë ishte e punuar me shumë shije. Në tavolinën e ambientit të ngrënies kishte shtruar mbulesën e kadifenjtë ngjyrë vishnje dhe mbi të kishte vendosur një çentro të re të punuar me grep, të cilën e kishte përfunduar vetëm një ditë më parë, dhe i kishte dalë shpirti që ta kollariste dhe ta kishte gati për ditën e sotme. Në mes të tavolinës kishte

vendosur frutierën e saj të madhe prej kristali, të mbushur me të gjitha frutat e stinës.

Dhespina vështroi përreth e kënaqur dhe buzëqeshi. Sa të bukur që e kishte shtëpinë! Josifi doli për të shkuar në dyqan, në orën që shkonte zakonisht, pasi puthi më parë të shoqen në të dyja faqet, ashtu siç e kishte zakon.

- Dëshiron të të sjell ndonjë gjë kur të kthehem? - e pyeti siç bënte çdo ditë.

- Meqë ma kujtove... merr pak tartar¹ te dyqani i erëzave, sepse nesër dua të përgatis ëmbëlsirë të bardhë... - iu përgjigj Dhespina para se ta përshëndeste dhe të bënte shenjën e kryqit pas tij.

Pastaj u bë gati edhe vetë për të pritur zonjat që kishte ftuar. Krehu flokët dhe hodhi pak aromë te shamia e saj, mbërtheu fustanin dhe veshi këpucët e saj me taka të ulëta. Fëmijët e saj, sepse ndërkohë kishte lindur edhe Elisonë, ishin bërë edhe ata gati, megjithëse nuk do të rrinin shumë gjatë. Do të përshëndesnin me një “mirëmbërma” plot mirësjellje dhe pastaj duhej të shkonin në dhomën e tyre. Ç’punë kanë fëmijët me të rriturit?

Të ftuarat filluan të vinin në orar dhe, siç ndodhte gjithmonë, e para ishte Urania, e cila do ta ndihmonte, madje, edhe për të qerasur. Erdhi momenti kur do të servirej glikoja. Me një pamje krenare, Dhespina vendosi kupën e kristaltë në mes të tabakasë, mbi pecetën e qëndisur dhe në krah vendosi gotat me ujë të freskët dhe lugët dhe doli për t’ua shërbyer. Dhe, si për dreq, qëlloi që e para në

¹ Tartar – substancë në formë pluhuri, nënprodukt i rrushit, që përdoret në pastiçeri për të rritur vëllimin e marengës, ose për të bërë më kremoze akulloren etj.

radhë ishte Julia... A ishte e nevojshme kjo? Mori lugën e argjendtë dhe e futi në kupën me gliko. Vështroi e habitur: petale trëndafili nuk dukeshin asgjëkund. E futi përsëri lugën, këtë herë më thellë, por përsëri asgjë, vetëm shurup. Dhespina u zverdh në fytyrë.

- Mojt zonja ime, vetëm shurup përgatite? - e pyeti me habi. - Po trëndafili ku është?

- Obobo... - ia bëri Dhespina, dhe pastaj me zë më të fortë: - Obobo!... S'ka më keq, o Shën Mëri!

Në dhomë ra heshtja. Dhespina gati sa nuk qante. Urania vajti menjëherë pranë saj.

- Mos u mërzit, Dhespina ime! - i tha me zë të qetë.

- Po ku vajti glikoja, a mund të më thuash? Dhe ishte bërë kaq e mirë këtë herë!

- Eh... ku vajti... ku vajti... Përsëri ai miushi yt do ta ketë bërë zarar, nuk e kupton?

- Keni minj? - pyeti me një zë të çjerrë Julia, dhe Uranisë iu ngritën nervat.

- Hajde moj dhe ti! Ku i gjetëm minjtë! Për Theanonë e kam fjalën! Ajo ia gjeti anën glikosë! Ta dish, përsëri me karficën e flokëve do ta ketë bërë pisllekun!

Fajtorja pranoi më vonë veprimin e saj dhe hëngri drurin që i takonte në sytë e përplotur të motrës së saj, të Elisosë, e cila ishte atëherë pesë vjeçe dhe adhuronte motrën e saj më të madhe.



Kur lindi Elisoja, Theanoja ishte pesë vjeçe. Lindja e së motrës nuk i bëri asnjë përshtypje. Kur e vështroi foshnjën, thithi hundën në mënyrë përbuzëse dhe e pyeti të atin:

- Po tani, çfarë do ta bëjmë këtë?

- Do të rritet dhe do të luani së bashku! - iu përgjigj Josifi.

- Unë kam Argjirin, - i tha Theanoja dhe vazhdoi: - Nuk dua asnjë tjetër. T'ia japim Muzaferes që nuk ka fëmijë!

Muzaferja ishte fqinja e tyre dhe e kishte merak të madh që nuk bënte fëmijë.

- Mos thuaj gjëra të tilla se do të hash dru! - iu drejtua i ati, dhe Theanoja nuk e zgjati.

Nuk e zgjati, por kurrë nuk ndryshoi mendim për motrën e saj më të vogël. E konsideronte si një barrë të tepërt, të trashë dhe, në përgjithësi, nuk i kushtonte rëndësi të madhe. Përkundrazi, Elisoja e adhuronte motrën e saj të madhe, besonte se vetëm Theanoja dinte, se vetëm ajo mund të arrinte gjithçka. I shkonte pas si një qen besnik, bënte gjithçka që ajo i thoshte, fjala e Theanosë ishte ligj për të... pas asaj të të atit, natyrisht...

Josifi nuk u tregua kurrë një baba i dhembshur, ashtu siç nuk ishte i ndjeshëm edhe si bashkëshort. Sigurisht që ishte korrekt dhe një familjar i mirë, por i rreptë dhe paksa vetmitar, në kundërshtim me Dhëspinën, e cila ishte tip shumë i shoqërueshëm dhe gjithmonë e qeshur. Asaj i dedikoej fakti që shtëpia e tyre kishte vizitorë pothuajse gjithmonë. Një herë në muaj do të kishin mbrëmje dëfrimi, dhe fëmijët i adhuronin ato net. Vinin zonja me rroba të bukura, dëgjoheshin të qeshura, zëra dhe muzikë. Në sallon kërcenin vals dhe tango... Vallëzonin... Të gjithë, përveç Josifit dhe Dhëspinës. Josifi nuk dinte të vallëzonte dhe Dhëspina... Dhëspinën nuk e lejonte Josifi... Kishte marrë udhëzime të prera nga burri i saj dhe nuk guxoi kurrë që t'i shkelte.

- Nëse të fton ndonjëri për vallëzim, do të thuash se nuk di të vallëzosh! - e kishte urdhëruar dhe ajo i ishte bindur...

Sepse Josifi ishte shumë xheloz për gruan e tij. Nuk kishte besim as te të afërmit, pale te miqtë. Dhespina nuk iu kundërvu kurrë vullnetit të burrit të saj, gjatë gjithë jetës, pavarësisht se shumë herë mund të kishte vuajtur ngaqë ai e tepronte. Gjatë mbrëmjeve të vallëzimit, bënte sikur kishte shumë punë, mbante ritmin e muzikës me këmbë poshtë tavolinës, por kurrë nuk vallëzoi, pavarësisht se kishte dëshirë të zjarrtë për një tango... Vetëm kur Josifi u përpoq t'i impononte atë që i kishte bërë dikur edhe i ati i tij nënës së tij, atëherë, për pak sa nuk arritën në buzë të greminës, dhe nëse nuk do të ishin Urania dhe Theofili, gjërat do të kishin marrë rrugë të keqe...

Kur u martuan, pas disa muajve, Josifi filloi t'i bënte vërejtje Dhespines se dilte shpesh.

- Si thua, të mos shkoj për të bërë pazar? - e pyeti një ditë Dhespina, pas vërejtjes që i bëri.

- Nuk e kisha fjalën për pazarin! - iu përgjigj prerë ai.

- Po atëherë, përse e ke fjalën?

- Ti nuk del vetëm për të bërë pazar! Herë shkon te nëna jote, herë te mikeshat e tua... Ku do të na çojë kjo?

- Çfarë po thua, Josif? Mikeshat e mia kanë ditë të caktuara që presin dhe unë atëherë shkoj, ashtu siç vijnë edhe ato tek unë. Nëse unë nuk do të shkoj, edhe ato nuk do të vijnë!

- E çfarë të duhen këto vajtje-ardhje? A nuk jemi mirë vetëm?

- Jo, nuk jemi mirë! Njeriu nuk është bërë që të qëndrojë vetëm, Josif!

- Mirë, por mua nuk më pëlqejnë këto vajtje-ardhje sa me njërën e me tjetrën!

- Çfarë po thua tani? Të gjitha i njeh, në një mëhallë u rrita me ato vajza...

- Po burrat e tyre?

- Po mirë, a nuk shoqërohesh ti me burrat e tyre? Pastaj... ç'punë kanë burrat e tyre në takimet tona të pasditeve? Burrat janë në punët e tyre, ashtu si ti!

Njëra fjalë solli tjetrën, derisa shpërtheu sherri. Në fund Josifi hoqi dorë nga diskutimi dhe filloi të jepte urdhra: “Nuk do të dalësh përsëri”, “Nuk do të flasësh me filanen”, “Nuk do të shkosh tek ajo tjetra”.

Dhespina u zemërua shumë, por u sëmur me plot kuptimin e fjalës kur Josifi bëri diçka të paimagjinueshme. Mori një shkumës dhe shënoi me të shollën e të gjitha këpucëve të saj.

- Tani do ta di që nuk do të shkosh gjëkund për aq kohë sa unë nuk do të jem këtu! - i tha.

Dhespinë, nga dëshpërimi i hipi temperatura. Nuk i fliste askujt, u mbyll në shtëpi. Buzëqeshja u zhduk prej fytyrës së saj. Urania u habit shumë, por as asaj nuk i tha gjë gjatë ditëve të para. Dhe kur Dhespina anuloi dy të enjte radhazi pritjet që ajo jepte pa asnjë arsye konkrete, Urania priti sa të largohej Josifi dhe shkoi në shtëpinë e kunatës së saj, e vendosur të mësonte se çfarë po ndodhte.

- Nuk do të largohem, - i tha, - nëse nuk më thua se çfarë po bëhet këtu brenda! Dha ta dish se nuk e bëj nga kurioziteti, por nga përkujdesja dhe dashuria! Ne jemi... si motra! Çfarë ndodhi që ndryshove kaq shumë, Dhespina? Mos ndoshta je sëmurë dhe po ma fsheh?

Dhespina hapi gojën që të mohonte, por në vend që të fliste, shpërtheu në të qara. Urania e përqafoi dhe e la që të shfrynte. Dhe kur dënesat pushuan, Dhespina e vështroi

kunatën në sy dhe i shpjegoi me një zë që i dridhej, të gjitha urdhrat që i kishte dhënë i shoqi. I tregoi edhe këpucët, që i kishte shënuar me shkumës. Urania e kishte humbur toruan. Sytë i ishin hapur tej mase nga habia, nuk dinte çfarë të thoshte dhe si ta ngushëllonte atë grua që qëndronte përballë saj dhe që ia kishte shkrepur prapë të qarit me dënese. Por në darkë, kur Theofili u kthye në shtëpi, ajo ia tregoi të gjitha bëmat e të vëllait.

- Po unë çfarë të bëj tani? - pyeti ai, dhe dukej që e kishte humbur toruan.

- Ta takosh dhe t'i flasësh! Vëllai yt është!

- Po bëhet kjo gjë? Të ndërhyj në problemet që ka çifti? Ku është dëgjuar kjo?

- Ti thua se do të jetë më mirë kur të dëgjohet që yt vëlla u divorcua? Sepse po ta them dhe do ta shohësh që kam të drejtë; Dhespina nuk do të durojë shumë! Do t'u tregojë njerëzve të saj dhe ata do ta marrin mbrapsht në shtëpinë e tyre!

- A thua se do të bëhemi rezil? Thua se krushqit do ta marrin mbrapsht?

- Pse, ç'kujton ti, do të lënë vajzën e tyre të vetme të fishket në duart e Josifit?

- Po si e bëri diçka të tillë ai mosmirënjohës?

- Xhelozia është këshilltare e keqe, o burrë... dhe Josifi është xheloz për Dhespinën!

- Po... por nëse nuk është kështu!

- Këto gjëra nuk kanë zgjidhje të ndërmjetme, Theofil: ose je xheloz dhe i çon gjërat në ekstrem, ose e ke mendjen në vend dhe nuk fillon sherrin pa pritur e pa kujtuar.

Askush nuk e mori vesh kurrë se çfarë diskutuan dy vëllezërit mes tyre. Madje as Ihsani, djaloshi i ri turk që

punonte në dyqanin e Josifit. Sepse Theofili vajti dhe e takoi të vëllanë në dyqanin e tij të vezëve, që të nesërmen. Gjeti një justifikim për ta larguar Ihsanin dhe mbetën vetëm ata të dy. Sidoqoftë, çfarëdo që u diskutua atë ditë, ishte e mjaftueshme që Josifi të ndërronte mendje. Në drekë, kur shkoi në shtëpi për të ngrënë, pa i thënë asnjë fjalë së shoqes, mori një leckë dhe fshiu shenjat e shkumësit nga këpucët e saj. Dhespina e kuptoi dhe i qeshi fytyra. As ajo nuk foli, por i gjithë shpirti u pasqyrua te sytë e saj në mënyrë të tillë, sa që dhe një dyshim të kishte Josifi nëse po bënte gjënë e duhur apo jo, u zhduk, ashtu siç u zhdukën edhe retë e zeza që qëndronin mbi martesën e tyre.

Jo se ndryshoi diçka tjetër, por me të gjitha gjërat e tjera Dhespina mund të jetonte.

E dashuronte të shoqin dhe e vërteta është se nuk kishte shumë ankesa.

Kur lindën dhe Theanonë, Dhespina tashmë ishte me të vërtetë e lumtur.

Gjatë verës, të dyja familjet i kalonin pushimet në Antigoni, në Pringjiponisin e bukur, në një shtëpi dykatëshe afër portit. Gratë dhe fëmijët domethënë. Burrat iknin në mëngjes, duke mbajtur *sefertasin*, enën metalike ku vendosnin ushqimin e drekës, dhe ktheheshin në darkë me anijen e vogël. Në port i priste familja dhe ata gjithmonë sillnin diçka për fëmijët. Herë ndonjë ëmbëlsirë, herë karamele apo biskota, dhe ndonjëherë edhe çokollata. Pas darke, Theofili, i cili kishte pasion këngën dhe kishte dhe zë të mirë, fillonte të këndonte, ndërsa gratë e shoqëronin me zë të ulët. Vite të lumtura...

Theanoja i adhuronte pushimet dhe nuk donte që ato të mbaronin. Elisoja ishte e vogël, nuk mund të merrte pjesë

në asnjë lojë, ndërsa ajo i shkonte pas Argjirit në lojërat që luanin, të cilat ndonjëherë bëheshin kaq të egra, saqë herë vriteshin te gjunjët, herë rripeshin nëpër duar, por gjithmonë dhe në mënyrë të padiskutueshme, viktimat e para ishin flokët e saj të krehura dhe kordelet në to, të cilat i humbiste në mënyrë misterioze... Theanoja i urrente tej mase gërshetat e saj dhe, më shumë, ato fjongot e mëdha, me të cilat lidheshin këta gërsheta. Ajo dëshironte të vraponte lirshëm, dhe po aq lirshëm të derdheshin dhe flokët supeve të saj, por Dhespina kishte pikëpamje shumë të rrepta për mënyrën se si duhej t'i mbante krehur flokët një vajzë në moshën pesëvjeçare. Por mënyra e të krehurit, që me të vërtetë e bënte Theanonë t'i mbusheshin sytë me lot, ishte me atë buklën gjigante në majë të kokës, që ia bënte e ëma për çdo rast feste, dhe që vazhdoi t'ia bënte derisa Theanoja mbushi dymbëdhjetë vjeç. Në atë moshë ajo kundërshtoi në mënyrë shumë të vendosur.

- Aman, moj nënë, mjaft më! Si japrak ngjan ajo gjëja që kam në majë të kokës! - i tha një ditë. - Deri kur do të më torturosh me këtë gjë?

- Dhe si dëshiron të të kreh, zonjëza ime? Nuk i shikon vajzat e tjera?

- Po pikërisht se i shoh se sa qesharake duken ato, e di që po aq qesharake ngjaj edhe unë!

- Moj ti, u çmende? Ç'po më dëgjojnë veshët nga një fëmijë?

- Dhe meqë jam fëmijë, nuk mund të di se çfarë më pëlqen dhe çfarë jo? E pra, kjo mënyrë të krehuri, nuk më pëlqen!

As shpulla që i flakëriti e ëma nuk i pëlqeu, por pas kësaj Theanoja vuri re se krehja antipatike u zhduk njëherë e përgjithmonë nga koka e saj. Hallall e pastë faqja shpullën që hëngri!...



Shkolla ishte dashuria e madhe e Theanosë. Ishte shumë e mirë në mësim, të gjithë mësuesit e vinin re zellin e madh të saj në shkollë, por përballeshin edhe me... hiletë e saj. Aty ku ndodhej Theanoja, do të ndodhte patjetër ndonjë prapësi. Një ditë, erdhi në shkollë një nxënëse e re. Mësuesja e prezantoi në klasë, u tha se quhej Joana, dhe se kishte ardhur me prindërit e saj nga Karakioj. Joana nuk e hapte kurrë gojën, vetëm nëse e pyeste mësuesja për diçka, por edhe atëherë mezi e dëgjonin, kaq me zë të ulët fliste. Sigurisht që në pushimet mes orëve të mësimit, ajo nuk e hapte gojën. Fëmijët e tjerë i afroheshin, e ftonin që të luante me ta, por Joana përgjigjej vetëm duke tundur kokën në shenjë mohimi dhe këmbëngulte të rrinte urtë në një prej stolave të oborrit të shkollës. Theanoja u tërbua nga kjo sjellje.

- Kush kujton se është? - i thoshte vazhdimisht mikeshës së saj Varvarës, me të cilën rrinte në një bankë.

- Po ty ç'të duhet që ajo nuk flet? - i përgjigjej Varvara, por Theanoja nuk e pranonte.

Fëmijët e tjerë, kur e kuptuan se Joana nuk reagonte për asgjë, filluan ta ngacmonin. Herë i tërhiqnin gërshetat, herë e shtynin, herë të tjera i zgjidhnin fjongot, por Joana vazhdonte të qëndronte si statujë, as që përpiquej t' u shmangej torturuesve të saj të vegjël. Madje edhe kur një prej djemve e shtyu kaq fort, saqë u rrëzua nga stoli, Joana, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, u ngrit, shkundi rrobat dhe u ul përsëri në stol pa hapur gojën. Në atë çast Theanoja u vërsul e papërmbajtur mbi të. E kapi për fyti dhe e shtrëngoi me aq fuqi sa kishte. Joana filloi të bërtiste me zë kaq të lartë, saqë aty u mblodh gjithë shkolla.

- Aha, pra tani po flet! - i tha e kënaqur Theanoja dhe e lëshoi.

Por nuk ishte aspak i kënaqur drejtori i shkollës, i cili e dënoi Theanonë duke e mbyllur në bodrum për dy orë të tëra. Së bashku me të, por në mënyrë fare të padrejtë, u dënua edhe Varvara si bashkëpunëtore. Në errësirën e thellë të bodrumit, Varvara nuk duroi dhe ia plasi të qarit. Përveç hartave, aty ishte edhe një skelet që përdorej në mësimet e klasave të shtata dhe të teta, dhe ajo u frikësua shumë. Por Theanoja, e cila e kuptoi se po i përgjonin nga vrima e çelësit, për të parë se çfarë do të bënin, nuk e dha veten.

- Pusho, moj! - i thoshte vazhdimisht. - Mos qaj, moj! Aty janë, jashtë derës e po na shikojnë!

- Po, por unë kam frikë! - qante e pangushëlluar shoqja e saj.

- Nga se ke frike, moj budallaqe? Nga skeleti? Nuk është prej vërteti! Dëshiron të të shohin ata që janë jashtë dhe t'ujijë keq për ty?

- Nëse kështu do të më nxirrnin prej këtu, atëherë po qaj më fort!

- Ah, moj Varvarë e shkretë, po nuk ke fare inat?

Jo, nuk kishte... Vetëm Theanoja kishte. Dhe shumë egoizëm. Askush nuk do ta quante ndonjëherë frikacake. Pas dy orësh, kur e mbaroi dënimin, doli prej andej me kokën lart, pa lot në sy dhe e papenduar, duke ecur në krah të Varvarës që ishte pothuajse e dërrmuar dhe u kërkonte falje të gjithëve. Thirrën dhe të atin e saj në shkollë, por ai nuk e qortoi, megjithëse Theanoja ia pati frikën... Sepse ajo vetëm nga i ati kishte frikë, megjithëse ai nuk i kishte prekur kurrë as dhe një fije floku. Mjaftonte vetëm shikimi i tij, që

Theanoja të fillonte të dridhej si peshku. Por, çuditërisht, këtë radhë i ati i saj nuk u bind për gabimin e së bijës...

Ndoshta sepse arsyeja e tij i tha se sjellja e Joanës shkaktoi reagimin e Theanosë... ndoshta sepse edhe ai vetë do të kishte bërë të njëjtën gjë në zemërim e sipër... ndoshta edhe sepse krenohej me faktin që vajza e tij e parë kishte kaq dinamizëm brenda vetes... Dhespina, gjithsesi, nuk u ndje aspak krenare, dhe kur mësoi mbi ngjarjen, e gostiti të bijën me një dru të mirë, duke i shkëputur edhe premtimin se nuk do të prekte kurrë me dorë ndonjë fëmijë tjetër.

Premtim që pas një jave u harrua, sepse Theanoja i theu dhëmbët një bashkënxënësi, i cili u tregua aq naiv sa ta ngacmonte, duke marrë si shkas një prej mënyrave që e ëma ia krihte flokët. Theanoja, që e urrente tashmë mënyrën e të krehurit të flokëve të saj, iu vërsul djalit, sapo ai filloi ta ngacmonte. Por ai ishte trupmadh dhe Theanoja e kuptoi se nuk do t'ia dilte mbanë. Kështu që u mbështet fort mbi këmbët e saj dhe pasi e rrotulloi me forcë çantën e saj të mbushur me libra, ia përplasi me forcë në fytyrë shokut të klasës, duke ia thyer dy dhëmbët e parë. Përsëri Theanoja u gjend në zyrën e drejtorit si e akuzuar dhe ditën tjetër në shkollë vajti e ëma... Doli e ngrysur nga zyra e madhe e drejtorit, e mbërtheu me forcë Theanonë nga krahu dhe pothuajse duke e hequr zvarrë, e çoi në shtëpi. Ndërkohë që po hante dru, fajtorja po shfajësohej.

- Nuk e preka me dorë, nënë, të betohem! - ngriti zërin në një moment dhe dora e Dhespinës ngeli pezull në ajër.

- Moj, po me mua do të tallesh ti? Drejtori m'i tregoi të gjitha, fije e për pe. Dy dhëmbë i ke thyer djalit!

- Po ato dy dhëmbë i lëviznin prej kohësh! Nuk e kam unë fajin!

- Theano, ki kujdes, se nuk do të shpëtosh lehtë prej meje! Herën e kaluar a nuk m'u betove se nuk do të prekje prapë asnjë fëmijë?

- Po nuk e preka fare, moj nënë!

- Po dhëmbët, vetë fluturuan nga vendi?

- Jo, me ndihmën e çantës! Por unë, ama, nuk vura dorë mbi të, për këtë të betohem!

Dhospina mbeti për një çast, duke mos ditur se çfarë të bënte, por shpejt vazhdoi ta rrihte me po të njëjtin ritëm.

- Copa-copa do të të bëj! Çfarë do të bëhesh, moj? Kujt i ke ngjarë? Lejohet të zihesh në këtë mënyrë? Po ai djalë i shkretë, çfarë të bëri që e sakatove?

- Më tha që të heq kuvaristrën nga flokët që të shihte nëse kisha pleshta aty brenda!

- Cilën kuvaristër? Çfarë po më thua?

- Ashtu si m'i kreh flokët, të gjithë tallen me mua... Dhe mua më erdhi ta shqyeja, por u kujtova që isha betuar që të mos prek asnjë fëmijë dhe e godita nga larg me çantë, në mënyrë që të mos shkelja fjalën e dhënë!

Dhospina nuk e rrahu më, por më vonë iu ankua kumatës së saj.

- Ç'të të them, moj Urani... kjo vajzë është ndryshe nga fëmijët e tjerë! Të dëgjosh se ç'gjëra më thotë!

- Është shumë e zgjuar vajza, Dhospina... Shumë e zgjuar!

- Mirë, po ku do të shkojë kjo punë kështu? Çdo javë më thërrasin në shkollë, nuk kam sy e faqe t'u dal përpara!

- E përse të kesh turp? Ngaqë vajza jote ia del mbanë dhe u tregon vendin të gjithëve? Pastaj, më mirë t'ia kenë frikën se sa ta mëshirojnë!

- E mirë, po ndonjë zgjidhje tjetër nuk ka? Ose njëra, ose tjetra?

As Josifi nuk e aprovonte shqetësimin e së shoqes për Theanonë. Madje, thellë brenda vetes ndihej edhe krenar me bëmat e saj.

- Lëre grua, - i thoshte... - kohërat janë të vështira, duhet të mësohet që t'ia dalë mbanë, ose me të mirë, ose me të egër!

- Por është vajzë, more burrë! - kundërshtonte Dhespina e shkretë. - Nuk janë gjëra të mira këto që bën!

Por pas pak Dhespina vuri re se bashkëshorti i saj psherëtiu dhe u ngrys në fytyrë.

- Çfarë ke që shfryn kështu? Ndodhi gjë në dyqan?

Josifi u ngrit dhe ndezi një cigare.

- Ndodhi diçka dhe nuk e di nëse duhet të kem frikë apo jo...

- Po më tremb, Josif. Çfarë ndodhi?

- Po ja... erdhi Jordani dhe u ulëm për të pirë një uzo.

- Po pastaj? Të tha ndonjë gjë dhe u trondite?

- Jo... çfarë të më thotë i shkretë... por tek rrinim dhe bisedonim, u fut ai turku... Ibrahim...

- Aman! Ai është spiun! Mos po diskutonit ndonjë gjë të keqe me Jordanin?

- Po jo, moj! Ç'të diskutonim... Por u harruam në bisedë dhe flisnim greqisht...

- Mos më thuaj! Si e bërë këtë ti?

- Po pra! Si u hutova kështu?

- E ç'u bë pastaj? Ju dëgjoi?

- Na dëgjoi dhe na qortoi! Kur dëgjova atë "*Turkçe konus*", pra "*Fol turqisht*", më ngriu gjaku!

- Thua se po na përgatit ndonjë grackë?

- Ç'të të them... unë u justifikova si munda... e kupton ti... pastaj i dhashë edhe një duzinë vezë me dy të verdha dhe u përshëndetëm si miq...

- Të lumtë, burri im! Mirë ia dole mbanë! Veçse kujdes, se ata nuk kanë besë! Tek të shtiren si miq, nga ana tjetër të bëjnë dhe gropën! Pse, pak hoqëm qëkur doli ai ligji, nga i cili nuk guxojmë të flasim gjuhën tonë?

Atë natë Josifi bëri gjumë të trazuar. Dhespina pranë tij e ndiente të rrotullohej në krevat dhe të shfrynte vazhdimisht. Kishin kaluar dhjetë vjet që atëherë kur Venizellos dhe Inonu kishin nënshkruar Traktatin e Miqësisë Greko-Turke. Pas nënshkrimit, gjendja ishte bërë disi më e mirë për grekët e Stambollit, por vetëm në dukje. Kazani ziente, por ishte i mbuluar mirë që të mos i dilte tymi nga poshtë... Grekët e Stambollit ishin gjithmonë si bezja e kuqe për demat, dhe pikërisht në atë periudhë iu imponua ajo: “Vatandas turkçe konus!”, domethënë “Qytetar, fol turqisht!”, ndërsa dy vjet më vonë, në vitin 1932, doli ligji “Për fyerje të turqizmit”. Ky ishte kulmi. Mjaftonin dy dëshmitarë të rremë që të depononin se dikush kishte folur kundër Turqisë dhe ai dikushi dergjej në burg... në rastin më të mirë... Gjithsesi, askush nuk e shihte më. Si do të guxonin, pra, grekët, të flisnin greqisht? Vetëm në shtëpitë e tyre, ajo racë këmbëngulëse fliste gjuhën e saj dhe ua mësonte edhe fëmijëve, duke u kultivuar dashurinë për një atdhe, të cilin as e kishin parë, dhe sipas gjasave, nuk do ta shihnin ndonjëherë...

Josifi, pas asaj dite, kaloi një muaj torturë. Kishte frikë nga çdo njeri që hynte në dyqan, madje edhe ta shikonte në fytyrë. I dukej sikur të gjithë ishin të gatshëm për ta arrestuar. Ishte bërë nevrík dhe acarohet shumë shpejt. Theofili e qetësonte, por edhe ai fshehurazi tregohej shumë i kujdesshëm.

Ishte pranvera e vitit 1941 dhe, siç e pranojnë pothuajse të gjithë, ishte pranvera më e mirë që kishte përjetuar

ndonjëherë Stambolli. Greqia fqinjë kishte rënë nën pushtimin gjerman dhe bashkë me të kishin filluar dhe torturat për popullin, por Turqia nuk ishte ngatërruar fare në këtë luftë. Gjithçka ishte e qetë dhe në paqe, dhe asgjë nuk e trazonte rrimin e jetës së grekëve të Stambollit.



Shtëpia e Josifit dhe e Dhespinës shkëlqente nga dritat. Festonte Elisoja. E kishin pagëzuar me emrin Elisabetë, dhe më 24 prill që festonte ditën e emrit, kishte dhe ditëlindjen. Festë e dyfishtë për familjen. Ishin mbledhur miq e të afërm, dhe Dhespina edhe një herë akoma kishte treguar se ishte një mikpritëse e përkryer. Në krah të saj, si gjithmonë, qëndronte Urania. Ajo që dukej sikur nuk merrte aq shumë pjesë në festë, ishte Theanoja.

Sigurisht që i pëlqente fakti që kishin të ftuar, por nxehej që të gjithë i thoshin se sa e lumtur duhej të ishte që kishte një motërz kaq të bukur, dhe pyeste veten përse askush nuk i thoshte se sa e lumtur ishte që kishte një kushëri si Argjiri... Askush nuk e kuptonte, ndoshta përveç teze Titikës, motrës së gjyshes së saj. Sa herë që Dhespina qahej dhe thoshte: “Sa e çuditshme kjo vajzë, o Shën Mëria ime! Ndryshe nga të tjerat!”, teze Titika vinte buzën në gaz. Ishte edhe ajo e veçantë dhe dinte ta respektonte atë që ishte ndryshe dhe ta dallonte kur ndeshej me të. Disa e quanin dhe tip halucinant kur ishte e re. Disa të tjerë e shihnin si krejtësisht të çmendur... veçanërisht atëherë kur braktisi të shoqin. Pothuajse i gjithë Stambolli e mori vesh lajmin, sepse në atë kohë divorci ishte një fjalë inekzistente. As tezja nuk e ndau ndonjëherë bashkëshortin, por as nuk jetoi me të. U martua

me të sepse ia dhanë për burrë, por shumë shpejt ai nxori në shesh karakterin e tij negativ, tendencën e tij drejt jetës së shturur dhe kryesisht dorën e tij shumë të rëndë... Tezja, menjëherë pas grindjes së tyre të parë dhe drurit që hëngri, mblodhi gjërat e saj dhe u largua. Asnjëri nuk ia doli që t'ia ndërronte mendjen dhe për Titikën e re të asaj kohe, paratë e të shoqit nuk ishin argument që ajo të vazhdonte të hante dru, dhe as të pranonte orekset e tij të çuditshme.

Natyrisht që hollësira nuk i tregoi askujt. Asnjë grua që kishte respekt për veten nuk fliste për gjëra të tilla, madje as me zë të ulët. Por të gjithë, veçse kuptuan, apo së paku dyshuan se çfarë po ndodhte, kur pak muaj më vonë ai u gjend i vrarë me thikë.

- Në bordello e gjetën mosmirënjohësin! - ia bënte njëri.

- Kishte marrëdhënie me njëren prej atyre... Klient ishte aty brenda, por kushedi përse e qëruan... - plotësonte tjetri.

- Po tani, Titika bëhet trashëgimtare? - pyeste një zonjë në dyqanin e perimeve.

- Deri edhe në groshin e fundit, - i përgjigjej tjetra.

Për muaj me radhë, ngjarjet në familjen e Titikës ishin bërë temë diskutimi për të njohur dhe të panjohur. Por ajo kishte kyçur gojën në mënyrë hermetike dhe nuk fliste me njeri për ato gjëra. Bëri, madje, dhe një udhëtim të gjatë, derisa të fashitej zhurma. Në një moment u kthye në Stamboll, por nuk qëndroi në shtëpinë e të shoqit. Shiti gjithçka dhe bleu një shtëpi në Antigoni, afër detit, dhe banoi aty vetëm. Gjatë verës, kur pushonin aty, Dhespina dhe Urania merrnin fëmijët dhe e vizitonin rregullisht.

Theanoja e donte edhe teze Titikën, por edhe shtëpinë e saj. Nuk ishte shumë e madhe, por kishte kopsht të madh dhe fiqtë më të ëmbël që kishte ngrënë ndonjëherë. Veç

kësaj, ishte edhe sjellja plot ëmbëlsi e vetë teze Titikës. Megjithëse Theanosë nuk i pëlqente shumë ta përqafojnë, prej Titikës pranonte gjithçka. Ndoshta sepse tregonte të njëjtën dobësi edhe për Argjirin... I merrte që të dy në prehër dhe u tregonte përralla të bukura. I qeraste me lëng të freskët vishnjeje, u qëronte arra dhe bajame dhe i mbulonte me të puthura para se t'i dërgonte për të luajtur, që të pinte edhe ajo kafënë me mbesën e saj. Theanoja e dinte se përse i largonte. Pas kafesë, ishte ora për të parë filxhanin... Titika dinte të lexonte ato shenjëzat e çuditshme që formonte kafeja turke, dhe si Dhespina, ashtu edhe Urania, e dëgjonin me shumë vëmendje. E pinin nxitimthi kafënë dhe pastaj ia jepnin filxhanin Titikës. Ajo e merrte, e rrotullonte një apo dy herë dhe pastaj e kthente përmbys.

- Dhe tani bëni durim derisa të bjerë llumi! - urdhëronte ajo, dhe dy gratë prisnin të ulura.

Pas pak tezja ngrinte filxhanin, ngrysej paksa në fytyrë dhe fillonte ceremoninë e interpretimit të shenjave... Theanoja ishte shumë kureshtarë që të mësonte ato që teze Titika shikonte brenda atij filxhani mikroskopik. Dhe ato duhej të ishin shumë, sepse tezes nuk i pushonte goja...

Një ditë Theanoja, pas ceremonisë së filxhanit, ndërkohë që gratë ishin futur në shtëpi ku tezja do t'u tregonte diçka, u afrua dhe mori në dorë njërin prej filxhanëve. E vështroi me kërshtëri. Si mund të lexonte dikush se çfarë thuhej aty brenda, përderisa aty nuk kishte shkronja? Të vetmen gjë që mund të dallonte ajo, ishte diçka që ngjante me rrugica të bardha ndërmjet shenjëzave të errëta... Ajo tjetra aty ngjante me një zog... Ndërsa tjetra më tutje ngjante me një lidhëse... Po në fund?... Çfarë ishte ajo fluskë e zezë?... Filluan t'i dhembnin sytë nga stërmundimi dhe nuk i dëgjoji gratë që u kthyen.

- Theano! Ç'po bën aty?

Zëri i rreptë dhe i fortë i së ëmës, e trembi. Filxhani i ra nga duart dhe u thye. Mbylli sytë dhe priste që të hante dru, por kjo nuk ndodhi, falë teze Titikës, e cila nxitoi që ta merrte hopa.

- E po, çfarë të bëjë shpirti im? Atë që sheh, atë bën! - tha ajo duke buzëqeshur.

- Nëse do ta heq nallanen dhe e fus në dorë, do t'ia tregoj unë! Vajzë e vogël dhe dashka të shohë dhe filxhanin, pale!

- Unë për vete, - filloi të fliste përsëri tezja, - në moshën e Theanosë isha kur fillova të pyes dhe të mësoj, dhe prandaj tani di të shoh dhe t'ju lexoj filxhanin! Po pse, gjë e keqe është?

Çdo gjë që mëson njeriu, në të mirë të tij është!

Kështu ia hodhi Theanoja dhe nuk hëngri dru atë ditë... Askush nuk mori vesh kurrë që teze Titika, fshehtazi filloi t'i mësojë ato shenjat misterioze të kafesë, të cilat shumë shpejt pushuan së qenët mistere për vogëlushen. Madje u konstatua se Theanoja kishte dhunti në këtë fushë. Kur mbushi pesëmbëdhjetë vjeç, dinte që ta shikonte filxhanin edhe më mirë se vetë teze Titika... Pikërisht në atë kohë që tezja vdiq dhe u la trashëgim shtëpinë në Antigoni...



Dimri i vitit 1942 ishte i ashpër në Stamboll, por akoma më i keq ishte në Greqi. Njerëzit vdisnin në rrugë nga uria dhe nga vuajtjet. Lajmet në Stamboll vinin të turbullta dhe zemrat e të gjithëve ishin të rënduara për ato që po ndodhnin në të gjithë botën, e cila dukej sikur kishte luajtur mendsh për shkak të një të çmenduri... Hebrenjtë po eliminoheshin

me metoda çnjerëzore dhe askush nuk donte të besonte ato që dëgjonte. Ishte e pamundur të ekzistonte një shtazëri e tillë...

Shtatorin e atij viti, për pak sa nuk humbën Uraninë nga një hemorragji që s'mund t'ia ndalonin. Ishte shtatzënë, por, për herë të tretë, nuk ia doli ta mbante fëmijën deri në fund të shtatzënisë. Vetëm se këtë herë, përveç fëmijës, për pak sa nuk humbi jetën edhe vetë...

Theanoja, që ishte vetëm shtatë vjeç atëherë, nuk kuptoi dhe shumë gjëra. Ajo gëzohej sepse Argjiri qëndroi në shtëpinë e tyre për plot pesëmbëdhjetë ditë. Në shtëpi erdhën gjyshja e saj, Elisoja, por edhe teze Titika, sepse nëna e saj i qëndronte pranë Uranisë që ishte shtruar në spitalin gjerman. Nga pëshpërimat e dy gjysheve, Theanoja kishte kuptuar se gruaja e xhaxhait të saj priste fëmijë dhe e humbi, dhe se nuk do të bënte më kurrë fëmijë tjetër... Por një vel i hollë misteri i mbulonte këto informacione. Si e humbi fëmijën? Dhe nga i rridhte gjaku teto Uranisë? Dhe përse të gjithë thoshin: "E shkreta Urani! Sa e pafat kjo grua!"? Ajo nuk kuptonte se ku qëndronte e keqja që nuk do të kishin edhe një fëmijë tjetër që do të bënte rrëmujë shtëpinë! A nuk u mjaftonte Elisoja? Për çfarë u duhej edhe një bela tjetër?

Por nga ana tjetër, ato pesëmbëdhjetë ditë, ishin për Theanonë një parajsë e vërtetë. Që të dyja gjyshet nuk ia prishnin qejfin. Loja fillonte që në mëngjes kur zgjoheshin dhe nuk mbaronte deri në darkë, kur shkonin për të fjetur. Por momentet më të bukura, më të ëmbla për Theanonë, ishin ato të pasdites: të mbledhur rreth sobës që kërciste nga drutë që digjeshin, piqnin gështenja, ndërsa teze Titika bënte garë me gjyshe Elisonë se kush do të tregonte

përrallën më të bukur. Në krah të saj qëndronte Argjiri duke përtypur gështenja, që atij i pëlqenin aq shumë, dhe duke qeshur kur dy gjyshet bënin sikur ziheshin se cila do të tregonte përrallën e radhës. Por gjithçka mbaronte, pritej si me thikë, në momentin që Theofili dhe Josifi ktheheshin të lodhur nga puna, për të ngrënë dhe për t'u çlodhur. Në atë moment fëmijët zhdukeshin nëpër dhoma dhe Theanoja i bënte veshët katër për të dëgjuar lajmet e reja që sillnin dy burrat nga spitali.

Vetëm pas një jave u duk sikur gjërat filluan të qetësoheshin, dhe bashkë me to, të çelëshin dhe fytyrat e të gjithëve. Dheshpinës iu kthye buzëqeshja dhe u tha fëmijëve se Urania pas disa ditësh do të kthehej në shtëpi. Theanoja e ndihmoi me aq sa mundej të ëmën, e cila pastroi cep më cep shtëpinë e kumatës, në mënyrë që ajo të mos kishte asnjë punë për të bërë kur të kthehej nga spitali, dhe u ndje krenare kur të gjithë i thanë “të lumtë” për ndihmën që kishte dhënë. Bashkë me Argjirin thyen një sasi të madhe arrash për përgatitjen e bakllavasë me të cilin do t'i uronin mirëseardhjen të sëmurës kur të kthehej. Sigurisht që më shumë se thyerjen e arrave, admiroi përgatitjen e saj, dhe u kënaq akoma më shumë kur teze Titika vuri re se u kishte mbaruar kanella dhe ajo, së bashku me gjyshen e saj shkuan në *Misir Çarshi*, në tregun egjiptian, për të blerë, veç kanellës, edhe erëzat e tjera që u kishin mbaruar.

E admironte shumë këtë treg Theanoja, megjithëse asnjëherë nuk iu ndanë teshtimat, në fillim të paktën, prej aromës së fortë të mijëra erëzave që shpërndahej në ajër nga thasët ku mbaheshin. Pas pak ajo ambientohej dhe atëherë shijonte atmosferën që krijohej nga gjithë ata njerëz, nga zallamahia dhe nga aromat... Gjatë gjithë jetës së saj e mbante

mend këtë aromë, që në fakt nuk ishte një e vetme, por një përzierje aromash. Aroma që lëshonte kanella bashkohej me aromën e karafilit dhe të dyja së bashku takonin më tej arrën moskate dhe pastaj mastikën, dhe në vazhdim atë të temjanit. Vështrimi ngopej nga ngjyrat e erëzave që përmbanin ato thasë, veshët mbusheshin prej tingujve, jo vetëm të njerëzve, por edhe të radiove, që përhapnin përreth këngë patetike turke për dashurinë. Lindja ishte fuqishëm e pranishme dhe shpërndante magjinë e saj në këtë treg. Theanoja ecte duke u mbajtur fort prej dorës së gjyshes së saj dhe thithte me ëndje aroma, tinguj dhe imazhe. Kur gjyshja ndalonte që të blinte diçka prej shitësve që preferonte, Theanoja kishte rast që t'u afrohej dhe t'u merrte erë atyre thasëve magjikë, të vëzhgonte me nge hanëmet me shamitë ngjyra-ngjyra si dhe turqit me festet dhe çallmat.

Gjyshja bënte pazarin dhe vazhdonin rrugëtimin në atë atmosferë të magjishme. Në fillim, rrjetën për pazar, e cila ishte bosh, e mbante Theanoja, por kur mbushej, ia merrte gjyshja.

- Ma jep mua rrjetën, vogëlushja ime, - i thoshte, - është e rëndë tani për duart e tua të vogla.

Ditën që Urania u kthye nga spitali, në tavolinë u shtrua mbulesa e mirë dhe u vendos edhe kompleti i veçantë i takëmeve. Shtëpia u mbush me aromën e gjellëve të shijshme. Urania sapo u fut, vuri buzën në gaz. Ishte ende e dobët dhe në vesh i kumbonte zëri i mjekut që i kishte thënë se nuk ishte në gjendje për të bërë fëmijë tjetër, por familja i qëndronte pranë për t'ia lehtësuar dhimbjen sa më shumë që të mundej. Sigurisht, ishte burri i saj ai që e kishte bërë të mblidhte veten, kur i tha:

- Nuk dua që të mërzhitesh, Urani! Zoti na dha Argjirin dhe t'i lutemi që të na e mbrojë gjithnjë. Ka të tjerë që nuk

kanë fare fëmijë. Ne jemi edhe me fat! Pastaj, duhet të dish se për mua, më tepër rëndësi ke ti. Ti të jesh mirë, asgjë tjetër nuk më intereson!

I tillë kishte qenë gjithnjë Theofili, prandaj dhe Urania e adhuronte.

I uruan të gjithë nga zemra që të ishte e shëndetshme dhe, pas buke, e çuan për t'u shtrirë, sepse ishte ende e dobët dhe i duhej që të çlodhej.

Gjithçka iu kthye rrjedhës normale. Teze Titika u kthye në shtëpinë e vet dhe gjyshe Elisoja në të sajën. Argjiri qëndroi edhe një a dy ditë aty, derisa Urania të merrte plotësisht situatën në dorë, dhe pastaj edhe ai shkoi në shtëpinë e tij. Theanoja mbeti në shoqërinë e Elisosë së vogël, e cila ishte atëherë dy vjeçe... Askush nuk e nuhati të keqen që po afrohej. Nuk kishte shenja, të paktën jo të dukshme.

Në mënyrë krejt të papritur dhe ndërkohë që Lufta e Dytë Botërore po vazhdonte, qeveria turke vendosi të përmirësonte financat e saj dhe të kontrollonte fitimet e paligjshme nga korrupsioni për shkak të luftës... Po të cilës luftë? Turqia nuk ishte ngatërruar fare në atë luftë. Vetëm u kishte ofruar "lehtësira", si gjermanit të çmendur ashtu edhe Aleatëve. Luante në dy fusha, kështu që edhe fitimet e saj ishin të dyfishta. Në fakt, problemi për Turqinë ishin grekët e Stambollit, helenizmi i Stambollit. Ky helenizim e bezdiste dhe tani Turqia kishte rastin për t'i dhënë edhe një goditje tjetër, në vazhdën e gjithë atyre goditjeve pararendëse, dhe goditjeve edhe më të tmerrshme që do të vinin më vonë...

Më 11 nëntor 1942, në një seancë të vetme të Parlamentit Turk, u votua ligji për "Taksën personale mbi pronën", ose *Varlik vergisi*, siç quhej ndryshe. Grekët e Stambollit duhej

të mbulonin njëzet për qind të të ardhurave prej kësaj takse, megjithëse përbënin vetëm pesëdhjetë e pesë për mijë të popullsisë së përgjithshme të vendit. Sigurisht, veç grekëve, do të paguanin edhe armenët, hebrejtë dhe, në përgjithësi, të gjitha popullsitë jomyslimane. Mënyra e vjeljes së taksës ishte e thjeshtë. Nëpunësit e tatimeve thërrisnin çdo banor jomysliman të Stambollit dhe i komunikonin shumën e detyrimit, i cili, sigurisht, ishte shumë i lartë, dhe këta banorë e kishin të pamundur ta shlyenin. Nuk donin të dëgjonin asnjë zë proteste, asnjë ankesë. Këto masa rrënuese për pronën e gjithsecilit kishin dhe një afat konkret zbatimi: brenda pesëmbëdhjetë ditëve...

Brenda pesëmbëdhjetë ditëve, banori fatkeq jomysliman duhej të shlyente detyrimin që i ishte kërkuar. Kishte të drejtë të merrte edhe një shtyrje pesëmbëdhjetëditore për pagesën e taksës, dhe në rast se përsëri nuk ia dilte ta shlyente, përfundonte në kampe pune të detyruar në Azinë e Vogël Qendrore, në Ashkale. Punonin në kushte çnjerëzore për ndërtimin e rrugëve për një pagë ditore prej dy lirash turke, një shumë qesharake për atë periudhë, nëse do të kemi parasysh faktin se për të shlyer detyrimet gjithë këta njerëz, duhej të punonin dy shekuj e më tepër secili! Prona të tëra u shitën për shuma qesharake. Mobilie, bizhuteri ari dhe argjendi, enë prej argjendi, shtëpi, dyqane dhe çdo gjë që mund të shitej, u shit, por përsëri për shumë njerëz këto shitje rezultuan të kota, sepse edhe shitën pronat e tyre, por edhe u dërguan në Ashkale, përderisa shuma nuk mjaftonte për shlyerjen e detyrimeve.

Josifi, atë natë shtatori, dhe vetëm dy javë nga kthimi i Uranisë nga spitali ku ishte shtruar, u kthye në shtëpi i menduar dhe nuk hapte gojë. Dhespina e vuri re, por nuk i

tha asnjë fjalë. I vuri për të ngrënë dhe pastaj mori fëmijët që t'i vinte në gjumë. Ndërkohë kishin zbritur edhe Theofili me Uraninë. Vetëm atëherë dy gratë hapën gojën për të pyetur.

- Hë pra, do të na thoni se çfarë po ndodh? - e mori fjalën Urania. - Nga sa po kuptoj, diçka serioze paska ndodhur, meqë të dy jeni në këtë gjendje!

Dy vëllezërit u panë sy më sy dhe Theofili e dha në heshtje aprovimin e tij që të fliste Josifi.

- Sonte ndodhi diçka që na vuri në mendime... - tha me një të folur të ngadaltë.

- Çfarë ndodhi? Doni të na nxirrni shpirtin? Çfarëdo që të jetë, na e thoni, që ta kuptojmë dhe ne! - tha Dhespina.

- Erdhi përsëri në dyqan ai Ibrahimimi...

- Aman! Mos më thuaj se po flisje sërish greqisht! - e ngriti zërin Dhespina tejet e frikësuar.

- Mbylle, moj grua, që të dëgjosh! Po përgatisja porosinë për Shën Benuanë, për shkollën... As që e kuptova kur hyri brenda... Pa e zgjatur, dërgoi Ihsanin në magazinë, dhe më tha gjëra shumë të çuditshme...

- E çfarë të tha konkretisht? - guxoi dhe pyeti Urania.

- Fillimisht më pyeti nëse kam ndonjë dyqan tjetër... Kur iu përgjigja se kisha, më pyeti nëse kisha dhe prona të tjera dhe më kërkoi që t'ia thosha...

- Po ti? Çfarë i the?

- E po, çfarë mund të bëja? Ia tregova ato që zotërojmë...

- Po ai çfarë të tha? Çfarë bëri? Me çengel do të t'i nxjerrim fjalët?

- Eh! Ai më tha: "Do të flas vetëm një herë, jo për herë të dytë, dhe bëj si ta mendosh, je njeri i zgjuar! Shiti tani çfarë ke e nuk ke, futi paratë në një arkë dhe ruajti mirë!".

- Kështu të tha? Ishte Urania që pyeste tashmë, shumë e shqetësuar.

- Fjalë për fjalë!

- Po ti, nuk e pyete se përse duhej ta bëje një gjë të tillë?

- E pyeta, si nuk e pyeta. I thashë: “ Ibrahim bej, ç’janë këto që më thua? Përse të shes çdo gjë që kam, kështu, pa asnjë arsye?”.

- Po ai, si t’u përgjigj?

- Më hodhi një shikim të egër dhe u largua!

Në dhomën e ndenjes ku ishin ulur ata të katërt, ra heshtja. Secili prej tyre ishte zhytur në mendimet e tij. Theofili, në një moment u ngrit, dhe filloi të bënte ecejake nëpër dhomë.

- Do të na thuash se çfarë mendon? - e pyeti Josifi pas njëfarë kohe.

- Ai pizevengu, që të më thotë mua gjithë ato gjëra, diçka di! Diçka ka për të ndodhur dhe do të na duhen pará, madje në sasi të madhe!

- Dakord, po pse të mos i shesim kur të vijë momenti që do të na duhen paratë? Përse tani?

- Sepse kur të vijë ai moment, burri im, - ia bëri Dhespina, - ndoshta nuk do të kesh mundësi të shesësh!

Të gjithë e vështruan me habi!

- Si të erdhi kjo gjë tani? - e pyeti Urania.

- Nuk e di... por që t’i thotë ai t’i shesë tani, di diçka...

- Dhe çfarë të bëjmë tani? T’i shesim?

Gratë pushuan dhe vështruan nga burrat e tyre.

- I shesim! - foli me një zë të vendosur Theofili. - Shesim gjithçka! Do të mbajmë vetëm dyqanet tona dhe shtëpinë. Asgjë tjetër!

Në dhomë mbretëroi sërish heshtja.

- Po vras mendjen dhe nuk mund të kuptoj se përse t'i tha këto fjalë! - foli pas pak Theofili.

- Edhe unë këtë po mendoj! Është e vërtetë që gjithnjë ka treguar njëfarë simpatie kundrejt meje, por kjo e sotmja ishte diçka krejt tjetër! Dhe vjen në momentin kur sapo kishim grumbulluar paratë për të blerë dyqanin në Pera!

- Do të na duhen edhe ato pará...

Theofili u mat një herë të rifillonte ecejaket, por pastaj u kthye nga dy gratë.

- Dhe ju të dyja, - u tha, - të kini kujdes!

- Nga çfarë të kemi kujdes?

- Mos bëni shumë shëtitje! Mos i ndani sytë nga fëmijët!

- Po me shkollën, si do t'ia bëjmë? Nuk do t'i dërgojmë më në shkollë?

- Për momentin do të vazhdojnë shkollën... por edhe ne, veshët ngrehur do t'i kemi... për momentin gjithçka është e qetë, por kurrë nuk i dihet...

Mbrëmja në vijim kaloi e qetë, por Dhespina e ndiente gjithë natën të shoqin në krevat të rrotullohej herë në njërin krah e herë në tjetrin, ngaqë nuk gjente rehat, ndërsa Urania vështronte të sajën që bënte ecejake nëpër dhomë.

- Akoma nuk u lodhe? - guxoi dhe e pyeti në një çast.

- Duhej të iknim! - iu përgjigj ai i ngrysur në fytyrë, dhe Urania u ngrit përgjysmë në shtrat.

- E ku të shkonim, pashai im?

- Duhej të merrnim familjen dhe të shkonim në Greqi!

- Po aty ka luftë, ore burrë! Nuk e dëgjon se ç'po bëhet? Po vdesin nëpër rrugica nga uria! Ku të shkojmë? Këtu është vendi ynë! Këtu janë prindërit tanë, varret e të parëve... ku të shkojmë?

- Nuk e di grua, po u lodha duke jetuar me frikë. Nuk mund të flas gjuhën time, dridhem të adhuroj Zotin tim dhe çdo ditë pyes veten se kur do të ngrihen për të na therë të gjithëve!

- Hajde tani, e teprove! Shumë mirë po jetojmë, kush të ngacmon? Me turqit, me shumicën e tyre, të paktën, jemi miq. Të bëri ndonjëherë ndonjë të keqe Fiqreti që ke në dyqan? A nuk sillet me respekt dhe dashuri? Më ngacmoi ndonjëherë mua shitësi i qumështit apo i fruta-zarzavateve? Po Ajnuri, që lan rrobat, më ktheu ndonjëherë fjalë? Çfarë të zuri sonte?

- Ti nuk di gjë, grua! Nuk rri në treg për të parë... Nuk po them, me shumicën prej tyre ia kalojmë mirë... Por janë edhe disa të tjerë që... helm u pikon nga sytë prej së keqes që kanë brenda tyre... Prej atyre kam frikë... prej fanatikëve... gjithmonë prej tyre vjen e keqja!

- Mos mendo për keq, Theofil! Gjithçka do të shkojë mirë, ke për të parë. Pastaj, ne nuk e dimë se për çfarë e kishte fjalën Ibrahim.

- Gjithsesi, ato nuk ishin fjalë të hedhura në erë. Diçka do të ndodhë... por çfarë ama? Përderisa ai flet për pará, nuk bëhet fjalë për ndonjë masakër...

- E po, jo kështu! Përse të na bien në qafë?

- Po armenët, përse i masakruan?

- Ore Theofil, tani po flet për historira të së kaluarës!

- Lutem që të kesh të drejtë...



Ditët që pasuan rrodhën të qeta. Sado që u përpoqën, as Josifi dhe as Theofili, nuk vunë re diçka të çuditshme

ose shqetësuese. Fjalët e Ibrahimit u ngjanin tani si të pakuptimta. Derisa diskutuan që të mos shisnin asgjë... Por dy gratë ishin shumë këmbëngulëse... Instinkti i tyre u thoshte se sa ishin në kohë, ata duhej të grumbullonin sa më shumë pará. Si përfundim, shitën gjithçka dhe, madje, me çmime kaq të mira, saqë u grumbullua një pasuri e tërë. Edhe tetori kaloi qetësisht dhe pa ndonjë zhvillim. Ibrahimit nuk u duk më në dyqan.

- Ta dish, grua, kot i shitëm të gjitha... - thoshte vazhdimisht Josifi, por Dhespina nuk bindej.

- Mos u sikletos, burri im, - i përgjigjej çdo herë ajo. - Nëse çdo gjë shkon normalisht, i blejmë përsëri. Nuk kanë për t'u zhdukur as dyqanet, as shtëpitë. Ne të jemi mirë!

Por vetëm pak ditë më vonë, lajmi për taksën e re, varlikun, u përhap porsí zjarri...

Josifi dhe Theofili ishin nga të parët që u thirrën nga nëpunësi i tatimeve dhe kur dolën prej zyrës së tij, shkuan drejt e në shtëpi, të zbehtë si të vdekurit, me rrathë të zinj poshtë syve. Dy gratë, të cilat në atë moment ishin në shtëpinë e Dhespines duke përgatitur glikonë me portokaj, u trembën kur i panë në atë gjendje. Harruan dhe glikonë në zjarr dhe ajo u dogj së bashku me tenxheren, dhe i flakën të gjitha... U ulën përsëri në sallon. Dhespina bëri kafe për të gjithë.

- U shkatërruam... - tha Theofili, ndërsa Josifi tundte kokën në shenjë pohuese.

U shpjeguan me dy fjalë ato që u tha dhe u kërkoi nëpunësi i tatimeve. Shuma që duhej të paguanin ishte e madhe. Të gjitha ato që kishin grumbulluar nga shitjet së bashku me kursimet e tyre, mundi i një jete të tërë, mezi e mbulonin këtë shumë.

- Ja përse të tha Ibrahimimi që t'i shesësh! - foli Urania.

- Po nëse dikush nuk e ka shumë që i kërkohet, çfarë ndodh më tej? - pyeti Dhespina

- Të gjithëve u japin një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh që të paguajnë... Pastaj... pastaj i çojnë të punojnë për shtetin derisa të shlyejnë detyrimet...

- E ku të punojnë?

- Në Ashkale... ashtu thonë...

- Në Ashkale! - zgurdulloi sytë Dhespina. - Në thellësi të Anadollit po më thua! Aty vdiq xhaxha Epaminonda në vitin 1914! Kampe përqendrimi ka aty!

- Të njëjtën gjë po përgatiten të bëjnë edhe tani!

- Por ne kemi, u the që do të paguajmë! - kërkoi që të sigurohej Urania.

- Kemi... por do të mbetemi pa asnjë grosh, ama!

- Lipsur qofshin dhe paratë! Të keni shëndetin, pa gjithçka rregullohet! Vetëm njeriu nuk vjen përsëri! - tha gruaja dhe bëri kryqin.

- A e merrni dot me mend se çfarë do të bëhet tani? - tha Theofili dhe vazhdoi: - Ata që nuk i disponojnë shumat që u kërkohen, do të fillojnë të shesin me çmime qesharake, për të shpëtuar kokën! Kush do t'i blejë ato prona? Turqit! Njerëzit do të shesin për një copë bukë, dhe përsëri nuk do të shpëtojnë!

Dhe ishte e vërtetë... Me lot në sy, dy familjet Jumurtaxhi panë se si miq dhe të afërm të tyre mbetën rrugëve, duke shitur jo vetëm shtëpitë dhe dyqanet e tyre, por edhe rrobat që vishnin, për të siguruar shumat monetare që u kërkonin.

Derdhën lot të hidhur për disa miq, të cilët ikën dhe nuk u kthyen më kurrë. Panë familje me emër, të shkatërrroreshin brenda një nate. Nuk kishte grua që të mos i kishte sytë e

skuqur nga lotët që po derdhte, por gjithçka ishte e kotë. Nëse këta lot do të mund të shndërroheshin në lira turke, do të shpëtonin të gjithë, kaq shumë ishin... Por kurrë këta lot nuk ishin të aftë për të shlyer ndonjë borxh... Helenizmi i Stambollit, edhe një herë tjetër, mori një goditje të fortë. Si një gjigant i plagosur, u lëkund përpara, mbrapa, iu morën këmbët, por nuk u rrëzua, qëndroi përsëri në këmbë. Pronat kaluan në duart e turqve, me dhjetëra familje humbën burrat e tyre, disa prej të cilëve nuk u kthyen kurrë, por “gjeni i kombit” ishte i fortë... Ajo racë këmbëngulëse rilindi si feniksi prej hirit të vet... Nuk ishte hera e parë, por nuk do të ishte as e fundit...



Jeta gjeti përsëri ritmin e saj. Në disa dyqane fytyrat e grekëve u zëvendësuan me ato të turqve, në disa shtëpi, pronarët, nga grekë që ishin më parë, tani u zëvendësuan me turq, por jeta vazhdoi. Kasafortat filluan të mbusheshin përsëri me të holla, të fituara me mund edhe djersë.

Disa muaj më pas, dhe ndërkohë që viti 1943 sapo kishte nisur, mund të ishte muaji janar apo shkurt, një të diel që familja ishte mbledhur në shtëpinë e Theofilut, Josifi tha atë që e mendonte prej kohësh. Së bashku me ta ishte dhe teze Titika, që edhe ajo kishte shpëtuar në saje të pasurisë së trashëguar nga i shoqi, si edhe gjyshe Elisoja. Pas buke dhe gjatë kohës që po pinin kafënë, Josifi u kollit për të pastruar fytin përpara se të fillonte të fliste.

- Dëshiroj t’ju them diçka që e bluaj në kokë prej javësh,
- tha ai dhe të gjithë e vështruan me habi.
- Për çfarë bëhet fjalë? - e pyeti i vëllai.

- Kaluam një furtunë të madhe dhe nuk e dimë se kur do të vijë tjetra në këtë vend që po jetojmë! Por për faktin që në këtë moment jemi në shtëpinë tonë dhe jo në Ashkale, i detyrohemi dikujt... Nëse nuk do t'i kishim shitur atëherë që i shitëm, të hollat nuk do të mjaftonin, edhe nëse do të kishim dalë në rrugë!

- Për Ibrahimin e ke fjalën? - e pyeti i vëllai.

- Po! Për atë...

- A e ke parë që atëherë? - pyeti Titika.

- Jo! Nuk u duk më në dyqan, por diçka më thotë se do të vijë!

- Dhe dëshiron t'i thuash faleminderit!

- Po, grua! Më duhet t'i them faleminderit, jo vetëm se na shpëtoi, por edhe sepse nuk e di se kur do t'ia kemi përsëri nevojën!

- Po, por tani nuk kemi më pará! - ia bëri Theofili, teksa Josifi ia nguli vështrimin.

- Por kemi bizhuteritë prej ari! - iu përgjigj ai, dhe fytyra e Theofilit u çel.

- Tani e kuptova! Do që t'i japim bizhuteri!

- Kështu them... Po ti, si thua?

- Aferim, vëllai im! Këtë them edhe unë! Gra, çfarë kemi gjendje dhe çfarë mund t'i japim?

- Për një qëllim të tillë? Edhe të gjitha i japim! Çfarë më duhen brilantet, përderisa kam burrin tim! - u hodh Dhespina, ndërsa Urania, pa hapur gojën, shkoi në atë moment dhe solli çantën e saj prej lëkure ku mbante bizhuteritë.

Për Ibrahimin zgjodhën një karficë të zbukuruar me diamante, një palë vathë, edhe ato me diamante, si dhe një byzylyk tek i cili vareshin monedha pesëlirëshe prej floriri. Këtyre, teze Titika u shtoi një karficë të të shoqit së bashku

me kopsat e manshetave, ku secila prej tyre zbukurohej nga një rubin.

- Po ti teze, përse? - e pyeti Dhespina.

- Ai më shpëtoi fëmijët e mi, gjakun tim, dhe nuk do të jap? Përveç kësaj, kaq të këqija që bëri në jetën e tij, i ndjeri im shoq, le të shërbejnë për diçka të mirë edhe gjërat e tij! Josifi ka të drejtë. Përderisa ju lajmëroi, ai mund t'ju shpëtojë edhe nga fatkeqësi të tjera në të ardhmen. Merri, jepja, dhe mos thuaj asgjë!

Josifi mblodhi bizhuteritë, i vendosi në një kuti të bukur dhe i mbylli në kasafortën e dyqanit, në pritje të Ibrahimit. Ishte e hënë në mëngjes dhe bizhuteritë kishin vetëm një javë që po prisnin, kur Ibrahim i u fut në dyqan. Josifi iu afrua me të shpejtë dhe i zgjati dorën.

- Ibrahim bej, mirë se erdhe në dyqanin tim!

Ibrahimi hodhi një vështrim përreth, për të parë nëse ishin vetëm.

- Vetëm jemi, - i tha Josifi, a thua se ia lexoi mendimet.

- Shoh që e paske dëgjuar këshillën time, ore kaur! - i tha gjoja me zë të rreptë ai.

- Ibrahim bej, kam muaj që pres për të të falënderuar. Nuk e di përse e bëre, por di që nëse nuk do të kishe qenë ti, tani do të kalbesha në Ashkale!

- Mati fjalët që thua, - ia preu hovin ai.

- Nuk po them asgjë. Unë nuk ngatërrohem me politikën, dhe ti e di këtë. Nuk di unë, si dhe përse. Unë jetoj në këtë vend dhe e konsideroj vendin tim. Nëse Turqia dëshiron të më trajtojë si të ftuar, kështu le të bëhet, por ta dish se unë e dua Stambollin. Këtu kam lindur, këtu dëshiroj që të vdes, në paqe dhe pa i rënë askujt në qafë.

- Deri këtu po flet mirë!

- Po unë nuk di gjë tjetër, Ibrahim bej. Shoh vetëm punën time, vetëm atë di të bëj. Por sa të jem gjallë, nuk do të harroj se më ke shpëtuar. Prandaj më lejo...

Josifi vajti mori kutinë dhe e solli, e hapi, dhe sytë e turkut u mbyllën përgjysmë prej shkëlqimit, kur Josifi i tregoi çfarë kishte brenda.

- Ç'janë të gjitha këto bre?

- Një falënderim nga unë dhe e gjithë familja ime. T'ia çosh gruas, t'i vërë, dhe të shkëlqejë, dhe në këtë mënyrë të kujtosh gjithmonë mirënjohjen e një kauri për të cilin të erdhi keq dhe e shpëtove. Merri, Ibrahim bej, hallall! Janë të gjitha kujtime të familjes dhe dua që t'i mbash ti!

As vetë Ibrahim nuk e priste diçka të tillë. Mori kutinë që i dha Josifi, dhe për herë të parë ndoshta u përkul me respekt të sinqertë para një greku. E përkuli edhe Josifi kokën me dinjitet dhe të dy burrat u përshëndetën. Porta u mbyll pas Ibrahimit që doli dhe atëherë Josifi kuptoi se sytë i kishte me lot.

Theanoja nuk ishte në gjendje të kuptonte asgjë prej atyre ngjarjeve të mëdha dhe të rëndësishme që po ndodhnin në shtëpinë e saj dhe në rrethin e saj familjar. Atë dimër të vitit 1944, ajo po përballej me problemet e saj në shkollë. Ishte në klasë më të lartë, mësimet ishin shtuar... Jo se e kishte problem këtë, problemi ishte në vend tjetër. Gjallëria e saj shtohet sa më tepër që rritej, por ishte e vështirë edhe ta qortoje. Për gjithçka e kishte një përgjigje, ishte e zgjuar dhe kur çapkënllëqet e saj dilnin në shesh, ajo i justifikonte kaq thjesht dhe me një shprehje të tillë pafajësie në fytyrë, sa që çdokënd e vinte në pozitë të vështirë. Një ditë, duke menduar se kallamari që mbante bojën ishte në gjendje të keqe, mori fshehurazi nga shtëpia shishen e shkëlqyesit të metaleve dhe gjatë orës së historisë, filloi ta fërkonte shishen e bojës

me të, në mënyrë që të shkëlqente. Ndiante një bezdi të tmerrshme për Mehmet Pushtuesin dhe bëmat e tij! Asaj i fliste e ëma për heronjtë e Revolucionit të 1821-shit dhe bëmat e tyre i dukeshin shumë më interesante! Heroina e saj e dashur ishte Bubulina, por këto gjëra ishin të ndaluara, jo vetëm që t'i mësonin në shkollë, por as t'i pëshpëritnin. Varianti turk i historisë ishte varianti i vetëm i pranueshëm, pavarësisht se kishte shumë të pavërteta...

Atë mëngjes, e gjithë vëmendja e saj ishte përqendruar te shkëlqimi i shishes së bojës. Fërkonte me forcë shishen e pisët të bojës, derisa e pikasi mësuesi.

- Jumurtaxhi! Ç'po bën aty? - i bërtiti, dhe Theanoja ndaloi menjëherë së pastruari.

E vështroi duke marrë shprehjen më të pafajshme në botë dhe iu përgjigj:

- Po pastroj shishen time të bojës, zoti mësues!

- Jashtë! - ulëriti mësuesi.

Theanoja, pa u ngutur, mbylli shishen dhe u ngrit. Arriti deri te dera, po u kthye përsëri te banka e saj.

- Ku po shkon, Jumurtaxhi? - u habit mësuesi.

- Të marr shishen, zotëri! - iu përgjigj e qetë Theanoja.

- Përderisa do të rri jashtë, të shkëlqej dhe dorezën e derës!

- Ulu në vend! E pacipë! - ngriti zërin mësuesi i mbytur në djersë, ndërkohë që nxënësit po qeshnin.

Por notat e saj ishin shumë të mira, sepse dhe vetë ajo ishte nxënëse shumë e mirë.



Marsi i vitit 1944 ngjante si festë për helenizmin. Turqia, duke parë që Luftës së Dytë Botërore po i vinte fundi, u

detyrua të lironte nga Ashkaleja të gjithë ata që kishin mundur t'u mbijetonin kushteve çnjerëzore në atë vend. Si hije të vetvetes së dikurshme, ata që ishin liruar filluan të ktheheshin, dhe sapo e morën veten, filluan të tregonin për të gjitha ato që kishin vuajtur aty. Në këtë mënyrë filluan të zbuloheshin përmasat e asaj shtazërie...

- Grua, u kthye Jordani! - i tha një ditë në drekë Josifi Dheshpinës.

- U kthye? Aman, mos më thuaj! A është mirë?

- Ende nuk e di... Më tha fqinja e tyre, Eftimia! Erdhi për të blerë dhe më tregoi. Askush nuk e ka parë, nuk ka dalë nga shtëpia. Me siguri do të jetë i sëmurë...

- Thua të jetë i sëmurë rëndë?

- Ndoshta. Kushedi se çfarë ka hequr aty.

- Nuk do t'i shkosh për vizitë?

- Them që pasdite të lë Ihsanin të më zëvendësojë dhe të hidhem një vrap...

- Aferim, burri im! Të të jap dhe unë një kavanoz me gliko me vishnje t'ia çosh...

Pasdite, me një kavanoz gliko vishnjeje dhe një qese me vezë në duar, Josifi trokiti, si me frikë, në derën e mikut të tij. Jordani tashmë banonte në një apartament të vogël që kishte vetëm dy dhoma. Shtëpinë e tij të bukur dykatëshe e kishte shitur me një të dhjetën e vlerës së vet, po ashtu edhe dyqanin, por meqenëse të hollat edhe pas kësaj nuk mjaftonin, u gjend në Ashkale. Sapo gruaja e tij, Afrodhiti, dalloi Josifin te dera, ia shkrepiti të qarit.

- Ti je, Josif? Mirë se na erdhe! Do të ndihet më mirë kur të të shohë! - ia bëri ajo dhe e ftoi të hynte brenda në atë apartament të varfër.

Josifi hodhi vështrimin rreth e rrotull, dhe ndjeu një sëmbim në kraharor. Mure të zhveshura nga pikturat e bukura, dyshemeja pa ato sixhadetë e dikurshme, as edhe një enë prej argjendi, as edhe një enë prej kristali... Vetëm mobiliet e domosdoshme... Afrodhiti fshiu sytë nga lotët.

- Këto na mbetën... - tha në një mënyrë të qetë dhe dinjitoze.

- S'ka gjë, Afrodhiti... Tani që u kthye burri yt, të gjitha do të rregullohen...

- Nuk po ankojem, Josif... Falënderoj Zotin që ma solli sërish...

- Si është?

- Shumë i dobët... Do të trembesh kur ta shohësh... Ka marrë dhe një të ftohtë të rëndë, ka shumë kollë, por mjeku më tha që nuk është gjë serioze... Pak ditë ushqim të mirë dhe ngrohje, dhe do të shërohet...

Josifi shkoi pas Afrodhitit në dhomën tjetër. Mbi shtrat, i shtrirë, ishte dikush që i ngjante mikut të tij, por nuk mund të ishte ai. Ishte katandisur sa gjysma e atij që kishte qenë, me sytë të futur thellë dhe të turbullt, me flokë pothuajse të thinjur. Dora e butë e së shoqes i vinte herë pas here në ballë kompresa me ujë edhe uthull që të mos i ngrihej temperatura. Josifi u afrua me hezitim.

- Jordan?

- Josif!

Të dy miqtë u përqaftuan të emocionuar. Afrodhiti u largua për t'i lënë të dy burrat vetëm dhe mbylli derën pas vetes. Nëse burri i saj kishte për të thënë ndonjë gjë, këtë do t'ia thoshte vetëm mikut të tij, dhe ai e dinte se sado vuajtje të kishte kaluar, këtë nuk duhej ta mbante përbrenda, përndryshe nuk do të qetësohej.

- Si je, Jordan? - e pyeti sapo u qetësuan pak.
 - Nuk po më sheh? Kam marrë fund, Josif...
 - Gruaja jote më tha se do të bëhesh mirë... Mjeku...
 - Trupi do të shërohet, Josif, por nga mendja ime nuk do të ikin kurrë ato që më panë sytë...

- Çfarë ndodhte aty? Do të më thuash?
 - Ferr... diçka e tillë duhet të jetë edhe ferri... Vetëm se në Ashkale bënte ftohtë, Josif... Bënte kaq ftohtë, saqë nuk besoj se do të ngrohem ndonjëherë në jetën time! Na kishin ngjeshur njërin pas tjetrit në çadra provizore, në mëngjes na duhej të pastronim rrugët nga bora që kishte rënë natën. Ishim pothuajse të zhveshur, të uritur, në gjendje të mjerueshme... Na hidhnin ca gjellë të shpifura për të ngrënë, ndërsa ujë nuk kishte asgjëkund... vetëm disa liqene, të mbushura me pislleqe, me jeshillëqe dhe bretkosa... Vija dorën në gojë, që të mos kapërdija ndonjë prej tyre... Dizenteria dhe ethet bënëin kërëdinë... As vetë nuk e di sesi mbijetova... sesi u ktheva... Zoti bëri mrekullinë e vet... A e mban mend zotin Lefter?

- Sarafini, që merrej me këmbim valute?
 - Po, atë! Nuk ia doli dot aty në Ashkale.
 - Mos më thuaj!
 - Nuk ia doli dot, i shkreti... ishte dhe i madh në moshë...
 Pas tri javësh vdiq!

- Po tani, çfarë do të bësh?
 Jordani, para sa të përgjigjej, uli vështrimin përtokë.
 - Do të iki, Josif... - i tha me zë të ulët.
 - Do të ikësh? E ku do shkosh?
 - Gjatë kohës që nuk isha këtu, Afrodhiti i shkroi xhaxhait tim... A e mban mend Perikliun?
 - Atë që iku në Amerikë në vitin 1928?

- Po, atë! Bëri prokopi aty... Sigurisht, në fillim pati vështirësi, por tani është rregulluar mirë... Do të shkoj tek ai... Këtu nuk ngeli gjë për ne... Edhe, që të jem i sinqertë, kam frikë edhe për fëmijët... Le të rriten në një vend të lirë, pa frikë, zemër...

- Është larg Amerika, Jordan... As gjuhën nuk e di...

- Do ta mësoj... Këtu mësova të ul kokën sikur të isha skllav, të dridhem nga frika për jetën time, të lutem për një pjatë gjellë... për pak ujë të pastër... Dua të harroj, Josif... Më duhet të harroj që të mos çmendem... Në këtë vend, kurrë më nuk do të ndihem i qetë... Punova një jetë të tërë që të bëhem njeri dhe shita gjithçka kisha për të shpëtuar, dhe përsëri, për pak... Përse të përpiqem përsëri të ndërtoj diçka, që nuk di se në ç'moment do ta humbas? Dhe, në fund të fundit, mund të humbas edhe jetën time. Jo, do të largohem!

Josifi u largua pikë e vrer nga shtëpia e mikut të tij. Në thellësi të shpirtit e admironte për kurajën që t'ia fillonte nga e para në një vend të huaj... Ai nuk e kishte këtë guxim... Sigurisht që Jordani, në atë pikë që kishte arritur, nuk kishte se çfarë të humbiste. Nuk i kishte mbetur asgjë... Po vetë ai ama? Nuk ishin njëlloj. Ai vetë zotëronte mjaft gjëra, si mund t'i linte dhe të ngrihej e të ikte? Pastaj, çfarë do të bëheshin njerëzit e tij? Vëllai i tij, kunata, i nipi, vjehrra e tij, teze Titika? Jo... ai nuk mund të largohej... U kthye në shtëpi dhe i tregoi gjithçka gruas, e cila u përlot për mikun më të mirë të burrit të saj dhe për fatin e tij të zi. Ajo falënderoi edhe një herë me vete Ibrahimin që i kishte paralajmëruar... Hallall të gjitha bizhuteritë që i falën... Prej vitesh, tashmë, kishte arritur në konkluzionin se kudo kishte njerëz të mirë dhe të këqij, pavarësisht Zotit tek i cili besonin apo

ngjyrës së lëkurës që kishin... Turqit, natyrisht, mbartnin trashëgiminë e rëndë të origjinës së tyre... Gjyshi i saj, i cili ishte një njeri shumë i kulturuar, thoshte gjithmonë se natyra i kishte pajisur turqit me një karakteristikë: grabitjen dhe shkatërrimin... Nomadë në origjinë, që u islamizuan, por duke ruajtur psikologjinë e grabitqarit, madje edhe kur u bënë shtet. Për shekuj me radhë, mënyra e sjelljes së tyre është vdekja e popullsisë së pambrojtur... Dhe vdekja është disa llojesh: është natyrore, por është edhe trupore dhe shpirtërore. Jo... Turku nuk bëhet mik... Dhe raste të tilla, si ai i Ibrahimit, për Dhespinën, përbënin thjesht një përjashtim që vërtetonte rregullin...



Lajmet për çlirimin e Greqisë dhe shembjen e Rajhut të Tretë mbërritën edhe në Turqi. Shumë njerëz, duke qenë se ngjarjet e fundit ishin ende të freskëta, u ngritën dhe ikën në Greqi, por vajtja e tyre aty përkoi me luftën civile greke dhe në fillim vuajtën. Jordani u largua dhe nuk dëgjuan më asgjë për të... Jeta ndoqi rrjedhën e saj normale...

KAPITULLI 2

(Dhjetëvjeçari i dytë, 1945-1955)

Viti i Ri 1945 u konsiderua prej të gjithëve se paralajmëronte një vit të mbarë. Shega, të cilën Josifi e përplasi në pragun e shtëpisë së tyre, shpërndau kokrrat e saj gjithandej, të kuqe dhe të ëmbla, shenjë e bereqetit që do të kishte shtëpia e tyre atë vit.

Dhespina mbushi një gotë me ujë dhe e theu atë në rrugë, për të larguar tersllëkun nga familja e saj. Edhe Theanoja, madje, e cila atë natë mbushi dhjetë vjeç, duartrokiti Elisonë gjashtëvjeçare, e cila, hipur mbi një karrige, recitoi një vjershë dhe i dha babait të saj thikën që të priste *vasillopitën*, kekun e përgatitur enkas për natën e Vitit të Ri.

Dorës së babait tim

Unë i jap një thikë të vogël,

Që të presë me të kekun

Dhe mua të më japë një copë.

Madje edhe “zënka” e shkurtër midis teze Titikës dhe gjyshe Elisosë, u konsiderua si... atraksioni i asaj mbrëmjeje. Dy gjyshet, të ulura pranë njëra-tjetrës në kanape, me shallet e tyre prej mëndafshi, me flokët të lidhur bukur në rrëzë të qafës, ishin pothuajse njëlloj si nga pamja e jashtme, ashtu dhe nga bota e brendshme shpirtërore. Asnjëra prej të dyjave nuk donte shumë të merrte flakë dhe të fillonte

sherri, dhe asnjëra prej të dyjave nuk lëshonte pe kollaj. Sebej për atë natë u bë fustani prej kadifeje që Titika kishte veshur në ceremoninë e pagëzimit të Theanosë...

- Moj motër, a e mban mend atë fustan prej kadifeje që kisha veshur në pagëzimin e së madhes? - filloi të fliste Titika, dhe Elisoja u tendos.

- Cilin fustan? Ti në ceremoninë e mbesës sime kishte veshur një prej taftaje!

- Ah, sikur ta dija që do të m'i ngrije prapë nervat sot! Moj, e di unë se çfarë kisha veshur, apo e di ti? Nuk e mban mend që kishte një lule të madhe dhe pastaj i thashë rrobaqepëses të ma hiqte se nuk më pëlqente dhe në vend të saj vendosa karficën e nënës së ndjerë? - këmbëngulte Titika, ndërkohë që Josifi dhe Dhospina vunë buzën në gaz. Urania u ngrit dhe qëndroi mbrapa dy grave, gati për të ndërhyrë.

- Moj ti, karficën e mamasë e kisha vënë unë atë ditë!

- Po pse, një karficë kishte mamaja? Kur ajo vdiq, një e more ti dhe një unë!

- Mos ma kujto se më ngre nervat!

- Po pse, moj?

- Sepse së bashku me karficën, nuk e di sesi, ti e binde nënën e shkretë dhe të dha edhe atë abazhurin që ia kisha vënë unë syrin!

- Po, por, edhe ti more kanapën! Apo e harrove?

E harruan fustanin dhe filluan me ato që trashëguan. Nëse do t'i linin, do ta vazhdonin sherrin për orë të tëra, me po atë intensitet dhe me kënaqësi të veçantë.

- Bëni gabim që ndërhyni! - i tha në një moment Theofili Uranisë. - Unë besoj se duke u zënë, ato harrohen, dhe kështu kalojnë dhe kohën!

- Po, more burrë, por a është gjë e hijshme tek i sheh që zihen si jevgjit?

Kështu që gjithmonë, ndonjëri prej tyre ndërhynte dhe ia prishte këtë lloj argëtimi të moshuarave.

Por atë natë, gjithsesi, sherrin e ndërpreu keku i Vitit të Ri dhe Shën Vasilit, sepse kishte ardhur momenti...

Theanoja i kishte shumë qejf festat dhe veçanërisht Krishtlindjet dhe Vitin e Ri. Shtëpia shkëlqente nga zbukurimet, përgatiteshin lloj-lloj ëmbëlsirash dhe askush nuk e ndalonte t'i provonte, dhe Theanoja gjithmonë preferonte ëmbëlsirat përpara gjellës. Dhespina bënte luftë të vërtetë që ta bindte të bijën të hante gjellë, veçanërisht mish. E mbante me orë në gojë, derisa bëhej si llastik, dhe vetëm atëherë, shpullat që i skuqnin faqet e bindnin që më në fund ta kapërdinte, së bashku me ujin dhe lotët me shije të kripur.

Kur Elisoja u rrit, gjërat u qetësuan përkohësisht, sepse pjata e Theanosë më në fund boshatisej. Derisa Dhespina zbuloi të vërtetën dhe filluan përsëri telashet. Theanoja i bënte presion të voglës, kështu që Elisoja hante, përveç racionit të saj, edhe atë të Theanosë.

- Haje, përndryshe do të hash dru! - e kërcënonte motra e madhe, dhe e vogla ishte e detyruar t'i bindej.

Kjo vazhdoi derisa u zbulua e vërteta, sepse Theanoja u kap në flagrancë dhe hëngri drurin që meritonte.

Pastaj u gjet një zgjidhje tjetër, të paktën për bukën. Theanoja e flakte mbrapa baules mbi të cilën uleshin për të ngrënë. Por u zbulua shpejt, kur Dhespina lëvizi baulen për të pastruar dhe nuk iu desh shumë mund për të kuptuar se kush ishte fajtori. E dërgoi pa ngrënë në shkollë, por edhe kur u kthye, Theanoja nuk pranoi të

kërkonte falje. E qetë, vështroi të ëmën në sy dhe i tha me një ton të ftohtë:

- Edhe tani të më lësh pa ngrënë, përsëri nuk e kam problem!

E tillë ishte Theanoja, kokëfortë dhe me karakter të ashpër.

Një ditë u rrëzua dhe iu rropën dy duart dhe e gjithë këmba.

Dy familjet, si gjithmonë, i kalonin pushimet verore në Antigoni dhe Theanoja, duke luajtur me Argjirin, u rrëzua dhe u vra. Argjiri, sapo e pa, filloi të bërtiste nga frika, por ajo e qortoi.

- Pusho, ore! Ngrite qytetin në këmbë!

- Po të kullon gj... gj... gjak! Argjirit po i merrej goja nga frika.

- E mirë! Një e çarë është, do të dalë gjak! Si bën kështu ti?

Hyri në shtëpi gjithë gjak. Dhespina me Uraninë po skuqnin patëllxhanë për të përgatitur imambajalldi dhe nuk i kushtuan rëndësi së voglës që rrinte dhe i vështronte, ndërsa nga duart dhe këmba gjaku i rridhte çurkë.

- Mos ndoshta mund të më fashoni këmbën? - pyeti ajo gjakftohtë.

Nëna e saj u kthye për ta pyetur përse i kërkonte diçka të tillë, dhe mbeti si e ngrirë.

- O Perëndi! - bërtiti. - Vajza!

Urania gati sa nuk e përmbysi tiganin nga tronditja. Mbretëroi paniku, por Theanoja, gjakftohtë si gjithmonë, i tha Uranisë:

- Hiqe tiganin se do të na shpërthejë zjarri!

As që iu drodh qerpiku për sa kohë e ëma dhe Urania po i pastronin plagët. Dhimbja duhej të ishte e madhe. Guriçkat

i kishin hyrë në këmbë dhe plagët ishin të thella. Vetëm Argjirit, i cili ndërkohë kishte vrapuar pas kushërirës së tij të dashur, i ra të fikët, dhe u desh që t'i jepnin një lugë sheqer që të merrte veten.

Josifi ndihej krenar me rezistencën që shfaqte e bija dhe nuk ishte dakord me të shoqen, që thoshte se një pandjeshmëri e tillë, nuk ishte gjë e mirë për një vajzë.

- Shumë e pandjeshme, ore burrë! Pikë loti nuk nxori për sa kohë po e fashonim me Uraninë! Asnjë pikë loti! As që i shtrëngoi dhëmbët!

- Po ti, përse mërzitësh? Çfarëdo që t'i qëllojë në jetë, do ta durojë. Nuk e kupton këtë?

- Fëmijë i ndryshëm nga të tjerët, Josif! Fëmijë i çuditshëm.

- Por shumë e bukur, moj grua! Nuk po them, edhe Elisoja e mirë është, por mos më thuaj... Theanoja do të bëhet një vajzë shumë e bukur. A e pe se çfarë shtati ka hedhur? Të gjithëve ua kalon në gjatësi, edhe Argjirit, që është dhe një vit më i madh.

- Një bukuri e tillë te gruaja nuk është gjë e mirë! Është bela!

- E po atëherë, ta martojmë shpejt!

- Mos bëj kështu, ore! Nuk i ka mbushur të njëmbëdhjetat akoma.

- Po nuk të thashë tani, moj!

Theanoja, duke mos ia pasur idenë se çfarë i shqetësonte prindërit e saj, vazhdoi të rritej dhe të bëhej gjithnjë më e bukur, duke injoruar atë që po i përgatiste fati në të ardhmen. Atë që nuk e priste, ishte vendimi i të atit që ta hiqte nga shkolla... Pothuajse nuk e besoi kur, me të mbaruar shkollën fillore, vendosën të mos vazhdonte tetëvjeçaren.

- Vajzat janë për shtëpinë! - tha Josifi dhe ky vendim i tij ishte përfundimtar dhe i pakthyeshëm.

Theanoja priste që ta mbështeste e ëma, por kjo nuk ndodhi. Dhespina ra dakord edhe një herë tjetër me të shoqin, por për të tjera arsye. E bija kishte hedhur menjëherë shtat gjatë dy viteve të fundit dhe, ashtu siç kishte parashikuar Josifi, ishte bërë shumë e bukur. Sytë e saj të mëdhenj dhe shprehës, flokët e saj të zinj, të gjatë dhe të dendur, trupi i saj, të cilin nuk arrinte ta fshihte as përparësja e saj rëndomtë dhe që ndërkohë po zhvillohej me ritme të shpejta, e trembnin Dhëspinën. Kështu që, e gjeti të udhës që Theanoja duhej të qëndronte në shtëpi derisa të vinte momenti që të martohej. Të qarat dhe lutjet nuk e ndihmuan aspak Theanonë.

Një rreze drite u duk kur vetë drejtori i shkollës erdhi për të takuar prindërit e saj dhe për të biseduar me ta. Ishte e diel pasdite kur drejtori i moshuar, zoti Arvaniti, kapërceu pragun e derës. Natyrisht që Theanoja nuk e përmbajti veten dhe e ngjiti veshin pas derës që ndante dhomën e ndenjjes nga dhomat e gjumit, për të dëgjuar ato që do të vendoseshin për të ardhmen e saj. Dhëspina e qerasi zotin Arvaniti me kafe, me gliko vishnjeje dhe ujë të ftohtë. Kur mbaruan me formalitetet, zoti drejtor u kollit thatë dhe pasi rregulloi syzet e tij mbi hundë, iu drejtua Josifit.

- Zoti Jumurtaxhi, qëllimi i vizitës sime është, ndoshta, paksa i pazakontë, por dëshiroj të më dëgjoni me vëmendje...

- Bëhet fjalë për diçka serioze?

- Unë e konsideroj serioze dhe, që të jem i sinqertë, nuk i kuptoj arsyet që ju çuan të merrni një vendim të tillë.

- Zoti drejtor, nuk e kuptoj përse e keni fjalën.

- Po flas për vendimin tuaj që të ndërprisni në mes shkollimin e Theanosë. Sigurisht, mund të jetë paksa e zhdërvjellët, por duke parë rezultatet e saj, duhet të kuptoni se është nxënëse e shkëlqyer. Është tepër e zellshme dhe ka një intelekt për t'u admiruar!

- Po, është e zgjuar, nuk po them, por... është edhe vajzë!

- Zoti Jumurxhi, kjo nuk ka të bëjë.

- Por çfarë i duhet një gruaje arsimimi i mëtejshëm? Mësoi të shkruajë, mësoi të lexojë, di të numërojë dhe të bëjë veprimet matematike, dijet shtesë për çfarë do t'i duhen? Qëllimi i gruas është të martohet, të bëjë fëmijë dhe t'i rrisë ata. Për çfarë do ta ndihmojë arsimimi i mëtejshëm?

- Kam shumë frikë se nuk ia keni idenë se çfarë po ndodh në botë prej disa vitesh!

- Çfarë po ndodh?

- Gratë në Europë, zoti Jumurtaxhi, tashmë arsimohen. Bëhen mjeke, juriste, shkencëtare. Arrijnë nivele të larta, dallohen në punë!

- Por këtu, zoti drejtor, nuk është Europë, këtu është Stamboll.

- Dakord, por nëse i jepni Theanosë mundësinë që të arsimohet, të arrijë shumë lart, mundet edhe të udhëtojë! I ka mundësitë. Po jua përsëris që është shumë inteligjente. Nuk jam i sigurt nëse kam hasur një fëmijë kaq të zgjuar gjatë pesë vjetëve të fundit!

- Të ketë një martesë të mirë dëshiroj unë, zoti drejtor, dhe jo t'i bjerë rrotull botës! Unë nuk e di se çfarë bëhet në Europë, siç na treguat ju, por unë dua që ime bijë të jetë këtu, afër meje.

- Por bota ndryshon, zoti Jumurtaxhi. Arsimimi, nga i cili doni ta privoni tani, ka mundësi që më vonë të shërbejë si armë e saj për një jetë më të mirë!

- Atë se çfarë është më e mira për fëmijën tim, e di unë. Nuk dua të më keqkuptoni, por unë nuk ndryshoj mendim, zoti drejtor. Theanoja mësoi ato që i duhen dhe tani do të qëndrojë në shtëpi derisa të martohet... Shumë-shumë, ta dërgoj në ndonjë shkollë për ekonomi shtëpiake... këtë po, mund ta bëj! Të mësojë të qepë, të qëndisë... Këto gjëra do t'i duhen më shumë se mësimet e shkollës!

Zoti Arvanit u ngrit, të njëjtën gjë bënë dhe Josifi me Dhëspinën.

- Nuk do të këmbëngul më, - tha i trishtuar, - por do të dëshiroja, tani që po iki, ta mendoni edhe një herë. Mund ta rregulloj që Theanoja të marrë edhe bursë. Është për të ardhur keq që po i bëni këtë padrejtësi... Ju uroj një pasdite të këndshme...

Kur dera u mbyll pas tij, Dhëspina iu afrua të shoqit, që ishte ulur përsëri dhe dukej i mendueshëm.

- Çfarë po mendon? - e pyeti.

- Këto që na tha drejtori... Ti, si thua?

- Nuk e di, Josif, Por më duket se more vendimin e duhur... M'u dukën të çuditshme të gjitha ato... Një grua mjeke! Ku është dëgjuar një gjë e tillë? Pastaj, përse duhet të udhëtojë vajza? Këtu lindi, këtu është vendi i saj, prindërit e saj... përse të ikë vetëm? E kur do të martohet? Nëse do të udhëtojë në të gjithë botën, kush do të martohet pastaj me të?

- Këto mendova edhe unë dhe thashë jo. Por ajo që tha në fund... Thua se po i bëjmë padrejtësi?

- Mbylle ore, ç'është kjo, i bëjmë padrejtësi thotë! E përse po i bëjmë padrejtësi? Të gjitha i ka! Ti po punon ditë edhe natë që të mos na mungojë asgjë. Po unë që nuk vajta fare në shkollë, pësova ndonjë gjë? Më mungon ndonjë gjë?

Kam burrin tim, fëmijët e mi... Mos u sikletos... Vendimi yt është i drejtë! Theanoja do të shkojë edhe në shkollën për ekonomi shtëpiake. Do të mësojë të qepë dhe të qëndisë, dhe nëse do t'i duhet ndonjëherë që ta nxjerrë vetë bukën e gojës, gjë që nuk e besoj, atëherë këto zanate do të jenë më të vlefshme sesa mësimet e shkollës, ashtu siç e the dhe vetë. Zoti drejtor bën punën e vet dhe ne bëjmë punën tonë si prindër! Pastaj, vajza jonë nuk është ndonjë e shëmtuar! Dhe nëse është e zgjuar, ashtu siç tha drejtori, atëherë le ta tregojë zgjuarsinë e saj duke ia prishur mendjen burrit më të mirë dhe më të pasur. Stambolli ka kaq djem të mirë, dhe mjaft të pasur madje!

Fjalët e Dhëspinës e qetësuan Josifin. Duke qëndruar pas derës, Theanoja kishte dëgjuar të gjitha ato që i duheshin *për të kuptuar se vendimi për të ardhmen e saj ishte marrë... Nuk do të shkonte më në shkollë... Nuk e dinte sesi ndihej. Pothuajse i vinte keq që kishte për t'i humbur ato ditë pa kokëçarje brenda atyre sallave të mëdha mësimore, me banka prej druri. Po ajo shkollë për ekonomi shtëpiake, çfarë mund të ishte vallë? Do t'i pëlqente? Të paktën, do të mësonte diçka...*



Në fillim u zhgënjye jashtë mase. I erdhi për t'ia shkrepur të qarit, kur ditën e parë të shkollës për ekonomi shtëpiake njohu “bashkënxënëset” e saj... Të gjitha ishin gra në moshë, disa, madje, dhe me fëmijë, dhe e vetmja në moshë të vogël ishte ajo. Me fjongo në flokë, me të njëjtat këpucë të sheshta e të trasha në këmbë dhe çorapet e trasha prej pambuku që i mbulonin pulpat, e ndiente se dallonte kaq shumë, sa që i

ngjante si diçka tragjike. U kthye në shtëpi me buzë aq të shtrënguara, saqë e ëma e saj u tremb.

- Ç'pësove? - e pyeti sapo hyri brenda.

Por Theanoja nuk iu përgjigj. Flaku çantën e saj të madhe prej lëkure në një skaj dhe u fut drejt e në dhomën e saj. Nuk guxoi ta mbyllte derën pas saj, ndërkohë që në të vërtetë do të donte ta përplaste kaq fort, saqë ta shkulte prej menteshave që e mbanin. Dhespina u fut pas saj dhe iu ul pranë.

- Do të më thuash se çfarë ndodhi që sillesh kështu? - e pyeti.

- E çfarë të të them, moj nënë? Theanoja, më në fund e hapi gojën dhe zëri po i dridhej nga zemërimi.

- Çfarë ndodhi, të më thuash! Atë të më thuash! Dita e parë e shkollës...

- Ajo nuk është shkollë! Sepse po të ishte, do të kisha nxënëse me të cilat mund të shkëmbeja dy fjalë, nuk do të kisha të bëja me... gjyshe! Ato brenda janë të gjitha gra në moshë!

- Kjo ishte e gjitha? Po pastaj? Çfarë të duhet? Ti shkon aty për të mësuar.

- A e dini se jam e vetmja që vesh këpucë të tilla dhe çorape të tilla? Të gjitha veshin këpucë me taka dhe çorape të gjata!

- E ç'kërkon tani? Të të vesh këpucë me taka? Dymbëdhjetë vjeçe je.

- Nuk thashë këtë. Por unë nuk do të shkoj më, nëse më dërgoni me fjongo të tilla me ngjyrë të kuqe në kokë.

- Fjongot ta kanë fajin tani?

- Vetëm fjongot? As përparësen nuk e vesh më! Nuk është shkollë aty!

- E çfarë të të vesh?

- Rrobat e mia, nënë, rrobat e mia! Ashtu si të gjitha. Të paktën të mos dalloj kaq shumë. Nëse donit të isha nxënëse, atëherë të mos më hiqnit nga shkolla!

Dhespina u tërhoq. Theanoja u çlirua më në fund prej përparëses dhe prej fjongove. Krihej vetë, duke i kapur flokët herë gërshet të thjeshtë, e herë duke i lidhur tufë nga mbrapa, që i shkonin shumë. Por nuk shpëtoi prej çorapeve të trasha prej pambuku dhe prej këpucëve të sheshta. Në këtë pikë, Dhespina u tregua këmbëngulëse dhe Theanoja, kur takonte ndonjë të njohur në rrugë, vendoste përpara çantën e madhe prej lëkure, që ato të mos dukeshin shumë...

Ashtu si në shkollën fillore, edhe në këtë shkollë, Theanoja tregoi talentin e saj. Nuk kishte asgjë që ajo të mos e kuptonte, nuk kishte asgjë që ajo të mos mund ta bënte, ndërkohë që tregohej krejtësisht indiferente për gjërat e lehta. Kur u jepnin detyra, ajo përgatiste gjërat më të vështira, por edhe më të bukurat. Në këtë mënyrë, i ndryshoi edhe të gjitha rrobat, sipas shijeve të saj. Përderisa në shkollë duhej të qepnin, që të ushtroheshin, ajo qepte për veten e saj, ndërkohë që Dhespina nuk mund ta kundërshtonte.

Brenda dy viteve të para, Theanoja ndryshoi krejtësisht. Ishte vetëm katërmëdhjetë vjeçe, por vishej më bukur se të gjitha në shkollë dhe në lagjen e saj, njëkohësisht, ishte edhe më e bukura. Ia kishte kaluar në shtat edhe nënës së saj, e cila shqetësohej çdo ditë edhe më tepër.

- Përse merakosesh tani, nuk e kuptoj! - e pyeste Urania.

- Moj Urani, a nuk e sheh? Po bëhet dy metra e gjatë!

- Po pastaj, gjë e keqe është kjo?

- Po, por, është ende fëmijë.

- E po, meqë ajo ka këtë zhvillim, ne çfarë duhet të bëjmë? T'ia presim këmbët që të mos zgjatet?

- Por nuk është vetëm gjatësia. E vështroj dhe herë pas here humbas toruan. Grua me të tëra! Dhe çfarë gruaje! Si një pikturë!

- Moj Dhespina, mblidhe veten. Nëna të tjera në vendin tënd, do të krenoheshin.

- Po edhe unë krenohem, por edhe kam frikë ndërkohë. Pardje, të dielën, pas meshës në kishë, dolëm një shëtitje në Pera... Vetëm të shihje se si e vështrojnë burrat! E di se si më erdhi, sikur më ra pika!

- Pse, çfarë prisje ti? Një alamet vajze të tillë të mos e shikojnë? Gjithë burrat do të mbyllin sytë, sepse kështu do ti? Pastaj, vajza jote është me mend në kokë, pse ke frikë?

- Moj, ka edhe më shumë se ç'duhet! A e di që nuk ka mbetur lëndë në shkollë që të mos e ketë bërë, apo që nuk mendon ta bëjë? Filloi me qepje dhe qëndisje... Pastaj i pëlqeu dhe vajti të mësojë se si bëhen lulet prej cope... Tani thotë se dëshiron të mësojë se si thuren dantellat me vegjë të vogla!

Theanoja ishte vërtet e gjithanshme. Përveç gjithë të tjerave, ishte bërë dhe mësuese katekizmi në kishën e shën Nikollës dhe, ndërkohë, që në fillim i dukej si diçka argëtuese, tashmë ishte kthyer në angari...

Jashtë ishte një ditë e mrekullueshme pranverore, ajo kishte veshur fustanin e saj të ri dhe, për më tepër, po e priste Argjiri, për të bërë një shëtitje në Pera. Tashmë ishte pesëmbëdhjetë vjeçe dhe kishte një dëshirë të zjarrtë që të dilte me shoqërinë. Por, ajo që i pëlqente më shumë, ishin vështrimet që i ndiente të nguleshin mbi të me admirim. E dinte që ishte e bukur dhe shijonte ndikimin e bukurisë së

saj te djemtë. I shikonte me bisht të syrit që e vështronin si të dalldisur dhe i vinte për të qeshur kur, duke u kthyer përnjëherë, ajo i kapte gafil, ata skuqeshin dhe nxitonin ta hidhnin vështrimin gjetkë. Për më tepër, e gjithë kjo lojë që përsëritej çdo të diel, gjatë shëtitjes pas meshës, përmbante edhe magjinë joshëse të së paligjshmes dhe të rrezikshmes... Nëse do ta diktonte i ati apo e ëma, do të hante dru sa për një vit.



Urania vështroi Dhespinën, që dukej e shqetësuar.

- Hë pra? Si thua? - e pyeti më në fund.

- Ku ta di unë? Çfarë të të them? A nuk është turp?

- E përse është turp? Theanoja qep shumë mirë, të gjitha i kanë zili rrobat që vesh.

- Po, por tjetër gjë është të qepë për vete dhe për familjen e saj, dhe tjetër të qepë për gratë e botës me pagesë! Ç' do të thonë njerëzit? Se e nxorëm për punë?

- Moj, unë nuk të thashë që të vini tabelë! Por te të njohurit, përse të mos qepë? Do të nxjerrë pará dhe le të përdoren për pajën e saj. Ja, për shembull, Katina, gruaja e Stathit, dëshiron të qepë një fustan për dasmën e kushërirës së saj. Pa Theanonë dhe i pëlqeu fustani që kishte veshur. Më pyeti se kush ia qep rrobat Theanosë, i thashë se e ka qepur vetë dhe tregoi interes. Pse, gjë e keqe është kjo?

- Po, por ku të shkojë Theanoja sa andej-këtej?

- Asgjëkund nuk do të shkojë, moj! Katina do të vijë këtu t'i bëjë provat!

- Ku ta di unë... Çfarë të të them? Të pyes dhe të atin. Të thotë edhe ai "po" dhe nëse dëshiron edhe Theanoja...

Josifi ra dakord me kusht që të ardhurat nga qepja e rrobave të përdoreshin për pajën e saj. Sa për Theanonë, ajo u çmend nga gëzimi. Ideja se do të fitonte pará me punën e saj, ishte një ëndërr e pakapshme që tani po i trokiste në derë. Tashmë ndihej e rritur, dhe fakti se do të kishte të ardhurat e saj, i jepte më tepër rëndësi kësaj ndjesie...

Fustani i Katinës pati sukses të jashtëzakonshëm. Nuk mbeti njeri në dasmën ku ajo shkoi, që nuk e pyeti se ku e kishte qepur. Klientela e Theanosë u rrit tej mase brenda një nate, por ajo i përzgjidhte klientet e saj dhe refuzoi si tipat e vështirë, ashtu dhe ato që nuk kishin trup të mirë, sepse rrobat e qepura prej saj nuk do të dukeshin bukur në trupa të tillë... Me paratë e para që fitoi bleu një makinë qepëse të re, më të shpejtë dhe më moderne. Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare kishte famën e rrobaqepëses më të mirë, madje arriti deri aty sa të krijonte dhe modelet e veta, të cilat, klientet i preferonin, sepse secila kliente kishte modelin e saj. Dhoma e saj ngjante më tepër me një atelie rrobaqepësie, dhe shumë shpejt, meqenëse nuk i nxinte të dyja motrat, Elisoja u transferua në dhomën-aneks që kishin ngjitur me dhomën e ndenjjes. E zhytur gjatë gjithë ditës në mes të stofrave, dantellave dhe penjve, ndihej sikur gjendej në parajsë. Aty gjente qetësinë e saj prej të gjithëve dhe prej të gjithave dhe harronte se sa shumë e mbyste mbyllja në shtëpi, se sa dëshirë kishte t'i shpëtonte kontrollit që ushtronte e ëma, i cili shtoej sa më shumë rritej Theanoja.

Dhospina ishte shndërruar në një cerber të vajzës së saj të bukur. Nuk e linte të shkonte asgjëkund, klientet kalonin më parë tek ajo dhe nuk e linte Theanonë të lexonte as edhe një revistë. Kur dilte për të bërë pazar dhe kthehej, puna e parë që bënte ishte të kontrollonte se mos e bija ia kishte

shtruar muhabetit, se mos kishte bërë thonjtë apo mos kishte dëgjuar radion për sa kohë ajo nuk ishte aty...

Por vetë Theanoja bënte durim. Tashmë ëndërronte një martesë që do t'i jepte lirinë, por pyeste veten sesi do të gjente njeriun e përshtatshëm, aq sa ia kishin kufizuar lëvizjet. Ngushëllimi i saj i vetëm ishte Argjiri. Një djalosh shtatëmbëdhjetëvjeçar, i bukur, i gjatë dhe ezmer, i cili e kuptonte gjendjen e kushërirës së tij dhe kujdesej sa herë të mundej, të shfaqej si një *deus ex machina* dhe ta nxirrte nga ajo gjendje herë me ndonjë shëtitje në Pera, herë me ndonjë shëtitje pasditeve në ndonjë pastiçeri për ta qerasur me ëmbëlsira dhe, kuptohet, çdo herë, sigurisht, me praninë e Elisosë së vogël... Por diçka ishte dhe kjo...



Marika ishte motra e vogël e një mikeshe të Uranisë dhe e vetmja kliente në shtëpinë e së cilës Theanosë i lejohej që të shkonte, sepse ajo kishte fëmijë të vegjël dhe nuk kishte ku t'i linte. Ishte një vajzë shumë e mirë dhe e bukur, nga një familje relativisht e varfër, por ishte martuar me Perikliun, i cili ishte i pasur. Historia e tyre ishte shumë romantike dhe Theanoja u entuziazhua kur e mësoi.

Perikliu ra në dashuri me Marikën kur ishte në vitin e parë të mjekësisë. E pa në kishë dhe që prej asaj dite nuk e hiqte dot nga mendja. E ndiqte kudo nga pas, vetëm e vetëm për t'i shkëputur një fjalë. Në fund i tha të atit të tij se dëshironte të martohej me të, por ai, sapo mësoi prejardhjen e saj të varfër, kundërshtoi në mënyrë kategorike. Çfarëdo që të thoshte i riu Perikli, sado kërcënime që nxirrte nga goja, i ati nuk ndërronte mendje,

derisa i biri u nxeu dhe i tha se do të martohej me Marikën, me apo pa aprovimin e tij.

- Shumë mirë! - iu përgjigj ai. - Përderisa e do kështu, zgjidh dhe merr! Unë nuk marr përsipër edhe të paguaj studimet e tua, edhe të të martoj njëkohësisht. Ose universitetin, ose Marikën!

- Marikën! - iu përgjigj Perikliu dhe u martua me të.

E braktisi universitetin dhe filloi punë në një dyqan ushqimor. Punoi shumë, më keq dhe se një hamall, që të jetonte me Marikën e tij, e cila e priste në darkë që ta çlodhte me dashurinë dhe ëmbëlsinë e saj. Por kur Marika mbeti shtatzënë me fëmijën e parë, atëherë e ëma e Perikliut nguli këmbë, e mori të shoqin dhe shkuan e i gjetën, kështu që familja u ribashkua.

Në kohën kur Theanoja njohu Marikën dhe filloi të shkonte te shtëpia e saj e bukur për t'i qepur rrobat, retë ishin ende larg. Marika kishte lindur fëmijën e dytë, Perikliu kishte hapur një dyqan në Pera dhe gjithçka dukej në rregull, por kishte thashetheme se Perikliu kishte marrëdhënie me një të ve.

- I ka marrë koka erë po të them! - i thoshte një pasdite Urania Dhespinës, dhe Theanoja që e dëgjoi, zgurdulloi sytë.

Po pinin kafënë të tria, ulur në dhomën e ndenjjes. Theanoja po qëndiste me të shpejtë një porosi për një kliente, sepse i duhej ta dorëzonte shpejt, dhe po dëgjonte bisedën e dy grave, por sapo u përmend emri i Marikës, filloi të vështronte nga Urania dhe mbeti pa lëvizur.

- E pamundur! - ia bëri Dhespina, dhe Urania ishte plotësisht dakord me të.

- Mojt, po zien vendi po të them!

- Por ai, për t'u martuar me të, hodhi në erë të ardhmen e tij! Çfarë kërkon tani?

- Ohu edhe ti! Bën sikur nuk di. Çfarë kërkojnë burrat? Se na dëgjon dhe vajza!

- E kush është ajo?

- Është një e ve nga Imbro, mora vesh! I vdiq i shoqi para një viti dhe ajo u vendos këtu. Kliente e tij, kështu u njohën!

- Mojt Urani, mos ndoshta njerëzit flasin nga ligësia? Dhespina nuk donte ta besonte.

- Ç'po më thua, mojt, ai ikën nga dyqani që të kthehet në shtëpi, dhe në vend që të marrë rrugën e zakonshme, kalon përmes kopshteve që të kalojë më parë nga shtëpia e saj. Të njëjtën gjë bën edhe kur shkon në dyqan. E kanë parë duke hyrë e duke dalë pas... njëfarë kohe! A do më tepër se kaq?

- E kush t'i tha të gjitha këto?

- Përballë shtëpisë së asaj banon këpucari im... gruan e tij ti e njeh. As miza nuk kalon pa e marrë vesh ajo! Ajo më tregoi!

- E kam të pamundur ta besoj! Po mirë, nuk ka turp ai njeri? Marika është si uji i kristaltë, i rri qiri në këmbë dhe ai harbon... mëkat, Shën Mëria ime! Po mirë, ajo nuk ka kuptuar asgjë?

- Çfarë të të them? Por e di si thonë: "I zoti e merr vesh i fundit!"

Theanoja nuk fliste fare. Vazhdonte të qëndiste, sepse e dinte që nëse merrte pjesë në bisedë, do ta largonin andej, por ajo donte të dëgjonte. Marrëdhëniet ndërmjet një burri dhe një gruaje përbënin një mister për të. Sigurisht që e dinte se pas martesës çifti flinte në të njëjtin krevat dhe se diçka duhej të ndodhte aty përderisa lindnin fëmijët, por nuk e dinte me saktësi dhe nuk kishte mënyrë që ta mësonte...

Nga disa revista që ia kishte dhënë fshehurazi një kliente turke për t'i lexuar, dhe që i fshihte te makina e saj qepëse, e kuptonte se dashuria duhej të ishte diçka unike, diçka që të bënte të fluturoje mbi retë, por çfarë lidhje kishte kjo me martesën?

Ishte e sigurt se nëna e saj, teto Urania, dhe të gjitha zonjat e nderuara që ajo njihte nuk duhej të kishin ndier asnjëherë ato që ndiente Sazijeja, heroina e bukur e romanit që kishte lexuar së fundmi... Diçka duhej t'i kishte bërë bukuroshi Nexhat, në breg të detit mbrapa shkëmbinjve, nën hënën e plotë, që ajo të ndihej aq e lumtur sa t'i jepej... Por çfarë ishte saktësisht kjo "t'i jepej"?

Theanoja nuk fjeti gjithë natën. Të nesërmen do të shkonte te Marika për provë, dhe ato që kishte dëgjuar, së bashku me pikëpyetjet e saj, e kishin shqetësuar. Në shtëpinë e Marikës, ato pikëpyetje u shtuan. Perikliu nuk kishte dalë ende dhe Theanoja po vëzhgonte se si silllej. Ishte mënyrë të sjelluri e një "njeriu që i kishte marrë koka erë" sjellja e Perikliut? Kur Marika veshi fustanin për provë, Perikliu duartrokiti i entuziazmuar dhe e puthi me pasion të shoqen, ndërkohë që Theanoja uli kokën me takt. Pas pak, e puthi përsëri në të dyja faqet dhe iku për në dyqan.

U kthye në shtëpi në drekë me një rrudhë të thellë midis syve dhe Dhespina, së cilës asnjëherë nuk i shpëtonin ndryshimet në humorin e së bijës, e vuri re menjëherë.

- Çfarë ke që dukesh sikur të ka rënë qielli në kokë? - e pyeti gjatë kohës që po shtronin tavolinën për drekë.

- Asgjë nuk kam! Si të erdhi?

- Nuk më erdhi, të njoh mirë! Ndodhi gjë kur ishte te shtëpia e Marikës?

- Jo... domethënë... uf, edhe ti nënë, kam frikë edhe të të flas!

- Përse, moj, më ke frikë? Gogol jam unë?

- Po ja... dje që po flisnit me teton... dëgjoja edhe unë...

- E po këtë e di! Aty ishte, do të dëgjoje! E shurdhër je? Sa me tepër rritesh, aq më tepër duhet të mësosh!

- Po, por sot që vajta, ishte dhe zoti Perikli aty! Nëse e shikonit, nuk do të besonit asgjë nga ato që tha teto Urania dje. Sillej gjithë ëmbëlsi me gruan e tij. E puthi te flokët, e lavdëroi për fustanin, i tha që është e bukur dhe i premtoi se do t'i blinte një varëse. Pastaj, para se të ikte për në dyqan, e puthi përsëri!

- Po pastaj?

- Po si është e mundur, moj nënë, që të ketë... të dashur dhe ta dashurojë kaq shumë gruan e tij, të jetë kaq i mirë me të?

- Nuk ka të bëjë! Burrat, Theano, janë të çuditshëm! Mund të dashurojnë edhe një, edhe dy gra! E kanë në natyrën e tyre! Kur të rritesh, do ta kuptosh. Tani shko në kuzhinë dhe sill sallatën, sepse babai yt do të jetë duke ardhur, e mos të na gjejë duke biseduar se do të zemërohet.

Theanoja u mat të largohej, por u kthye përsëri. Këtë moment intimiteti nuk do ta linte t'i shkonte dëm.

- A mund të të pyes edhe për diçka tjetër... pa u zemëruar?

- Thuaje dhe shohim e bëjmë!

- Zoti Perikli... fle në të njëjtin krevat me të dyja?

- Ç'janë këto fjalë që më thua, moj? Ku i mësove ti këto gjëra?

- Po nuk thashë gjë, moj nënë! Thjesht pyes veten nëse sillet si i martuar edhe me gruan e ve.

- Eh... po! Sillet si i martuar me të dyja! Shko tani! Bëj atë që të thashë dhe mos mendo gjëra të tilla! Je ende e vogël!

E vështirë që të bindej... Ishin të shumta pikëpyetjet, ndërsa njohuritë dhe përgjigjet për to, nuk kishte nga t'i merrte. Kjo historia me Marikën kishte hapur kacakun e Eolit duke shkaktuar furtunë në mendjen e saj. Bile u përpoq të pyeste edhe Argjirin. Ai ishte më i madh në moshë, diçka duhet të dinte. Dyshonte, madje, se kushëriri i saj prej kohësh kishte vizituar shtëpi publike... Jo se e dinte se çfarë ishte ajo, sepse disa fjalë aty-këtu që kishte dëgjuar, më tepër e kishin ngatërruar më keq... Sidoqoftë, diçka e keqe ndodhte aty, diçka që kishte të bënte me atë që ndodh mes një burri dhe një gruaje... Por Argjiri, kur filloi që ta pyeste, u egërsua dhe ia ndaloi që t'i bënte pyetje të tilla në të ardhmen. Arriti në konkluzionin se ajo çka ndodh në çift, është e mirë vetëm në rast se janë të martuar. Kur nuk janë të martuar, është gjë e ulët dhe e keqe...

Por as këtë nuk e kuptonte... Me një fjalë, nëse ha gliko ftoi kur je i pamartuar është krim, ndërsa kur je i martuar është gjë e mirë... Si mund të jetë i njëjti veprim dhe i mirë dhe i keq? Dhe përse një burrë ka të drejtë të dashurojë dy gra njëkohësisht, ndërsa një grua nuk mund ta bëjë këtë gjë? Po gratë, nuk janë njerëz? A nuk kanë edhe ato të njëjtën zemër?

Por më pas gjërat u ngatërruan edhe më keq, sepse Theanoja u bë pa dashje dëshmitare e një skene të cilën nuk mund ta besonte, pavarësisht se u zhvillua në praninë e saj. Ishte përsëri në shtëpinë e Marikës, këtë herë për t'i qepur një kostum. Po e mundonte shumë sepse kishte prerje të vështirë, dhe pasi mbaroi provën, u ul për ta ildisur që të bënin një provë të dytë, dhe pastaj do ta përfundonte në shtëpinë e saj. Perikliu, gjithmonë në formë, përshëndeti me mirësjellje Theanonë, puthi me ëmbëlsi të shoqen dhe doli. Theanoja, ulur në një cep, po punonte me shpejtësi.

Nuk kishin kaluar as pesë minuta që kur ishte larguar Perikliu, kur ra përsëri zilja dhe në shtëpi hyri me vrull e ëma e tij. As që e vuri re Theanonë që po punonte te qoshja e saj.

- Mirëmëngjesi, nënë, - e përshëndeti e buzëqeshur Marika, por vjehrra e saj nuk kishte kohë për gjëra të tilla.

- Lëri përshëndetjet dhe eja të ikim! - bërtiti ajo.

- Ku të shkojmë që në mëngjes, nënë?

- Shkojmë ta nxjerrim nga aty ku është futur! Tani u fut, e pashë me sytë e mi!

- Nënë, ç'po thua? Kë të nxjerrim, dhe nga ku?

- Burrin tënd! Dhe mos më thuaj që nuk di asgjë, sepse nuk do të besoj! Të gjithë e dinë për bëmat e tij me atë gruan e ve dhe unë nuk duroj dot më! E kam djalë, por padrejtësinë askush nuk e do!

- Nënë, e ke gabim! Unë nuk kam për të shkuar gjëkund! Dhe këto që the, zëre se nuk i dëgjova fare! Unë nuk kam ankesa për burrin tim!

- Moj ti, nuk dëgjove se çfarë të thashë?

- Jo! Dhe nuk dua të dëgjoj asgjë tjetër! Nëse ju keni diçka me djalin tuaj, unë nuk ngatërrohem! Burri im është i mirë dhe i sjellshëm me mua, ashtu siç ishte para se të martoheshim.

- Nuse, do të më çmendësh! Ti nuk je kafshë, i kupton ato që po të them! Përse bën sikur s'di gjë?

- Sepse kështu duhet! Dhe më falni që po jua them, por edhe ju, nuk bëtë mirë që erdhët sot këtu për të më thënë këto gjëra! Nëse dëshironi, ejani t'ju bëj një kafe që të qetësoheni... Pastaj rrini të shikoni dhe nipat...

Por vjehrra e saj nuk qëndroi. E vështroi Marikën sikur kishte të bënte me një të marrë, dhe iku. Kur dera u mbyll

pas saj, Marika hodhi sytë nga Theanoja që kishte mbetur me gjilpërën në dorë.

- Më falni... - tha me hezitim Theanoja, duke mos ditur se çfarë të thoshte tjetër.

- Po ti, përse kërkon falje? - e pyeti e qetë Marika. - Unë do të duhej të të kërkoja falje, por siç e vure re, nuk arrita ta frenoj! Dhe tani ke mbetur edhe ti e habitur...

- Mua nuk më takon!

- Theano, je ende e vogël për të kuptuar...

- Disa gjëra i kuptoj... por ti, përse...

- Përse nuk vajta me të... që ta “nxirrja nga aty brenda”?

- Po... domethënë...

- Po pastaj? Çfarë do të bëhej pastaj? Theano, në këto raste nuk ka zgjidhje të ndërmjetme. Ose shtiresh sikur nuk di gjë me shpresën se do të mërzitet dhe do të shkëputet, ose bën atë që donte vjehrra ime dhe pastaj mbledh plaçkat dhe largohesh. Por unë nuk mund të largohem.

- Po pse? - guxoi të pyeste Theanoja.

- Sepse e dashuroj burrin tim... edhe ai më dashuron... Thjesht burrat janë pak mendjelehtë dhe shkojnë lehtë në shtrat me çdo grua që e dredh bishtin, dhe ajo, siç duket, ia drodhi mirë bishtin... Por zemra e tij më përket mua, dhe për këtë jam e sigurt! Le ta lëmë, pra, të kujtojë se diçka po bën!

- Po ti? Nuk dëshpërohesh?

- Përpiqem të mos mendoj se largohet prej meje për të shkuar në prehrin e asaj tjetrës apo që vjen dhe mban akoma aromën e trupit të saj...

- Nuk kuptoj asgjë...

- Je ende e vogël, prandaj... Kur të martohesh, nëse do ta duash burrin tënd, ashtu siç e dashuroj unë timin, do ta

kuptosh. Preferoj që ta ndaj me atë, se sa të mos e kem fare! Momentet që përjetojmë bashkë janë ato që më japin kurajë për të vazhduar dhe për të harruar atë që po ndodh mbrapa shpinës sime! Të vetmen gjë që kërkoj prej teje, është që të mos i thuash njeriu atë që ndodhi sot këtu...

- Të premtoj... Nuk do të them asgjë derisa të jem gjallë!

Theanoja e mbajti premtimin e saj. As nënës së saj nuk i tregoi çka ndodhi atë ditë në shtëpinë e Marikës. Papritur i dukej se kishte hedhur një vështrim nga dritarja, në shtëpinë me misteret e të rriturve, dhe këtë gjë nuk do ta ndante me askënd. Por e keqja ishte se përsëri nuk u kishte dhënë përgjigje pikëpyetjeve të saj, ndoshta kishte shtuar edhe të tjera, por, në një mënyrë të çuditshme, ndiente se kishte ndarë me të rriturit një copë të botës së tyre.

Por, gjithsesi, për një gjë ishte e sigurt. Se ajo, nuk do të dashuronte kurrë kaq shumë, sa të binte viktimë në duart e ndonjë burri, i cili do të tallej me të, por ajo nuk do ta dëbonte nga frika se mos e humbiste... Tekefundit, dashuria, çfarëdo që të ishte ajo, kishte forcën që të skllavëronte edhe mendjen, edhe trupin, por ajo nuk e dëshironte diçka të tillë. Dëshironte të ishte plotësisht e ndërgjegjshme si për pikëpamjet ashtu dhe për veprimet e saj, dhe ky ishte një premtim që ia dha edhe vetes dhe Argjirit. Ishte i vetmi me të cilin mund të fliste.

- Çfarë do të thuash me atë që nuk do të dashurosh kurrë në jetën tënde? - e pyeti ai kur ia tha.

- Këtë që të thashë.

- Dhe si do të martohesh, atëherë?

- Tjetër gjë dashuria dhe tjetër martesë!

- E ç' di ti nga këto? Ti je ende shumë e vogël dhe bëjmë shumë keq që bisedojmë gjëra të tilla ne të dy!

- Dhe me kë t'i bisedoj, Argjir? Kush më kupton më mirë se sa ti? Apo ndoshta preferon që të shkoj e të bisedoj me nënën time?

- Bah, lëre fare më mirë!

- Këtë them edhe unë.

- Mirë, po si të erdhi tani që më thua gjëra të tilla?

- Sepse kohët e fundit po i mendoj shumë, prandaj!

- Më duket se po të vjen koha për t'u martuar!

- Domethënë, ai që mendon për dashurinë, duhet edhe të martohet? Hajde, Argjir, po shkon dhe ti me mendjet e prindërve tanë, më duket. Pra, edhe ti... duhet të martohesh, dhe shpejt madje!

- Unë? E përse?

- Sepse, nga sa kuptova, kohët e fundit, si shumë po... merresh me dashurinë!

- Mbylle, moj! Nuk të vjen turp?

- Ty duhet të të vijë turp që shkon... e di ti ku shkon!

- Theano, nëse nuk pushon, do të iki dhe nuk do të të flas më me gojë!

- E mirë, mirë. Përfundimisht, të gjithë hipokritë jeni! Mirë është që të bëhen ato që bëhen, mjafton që të mos i diskutoni. E pra, unë nuk ju ngjaj në këtë gjë! Së fundmi, më thanë se një burrë mund të dashurojë një grua, të flejë me të dhe njëkohësisht të ketë edhe dy të tjera. Mirë e thashë?

- E kush t'i tha të gjitha këto?

- E po, meqë do ta dish, nëna ime m'i tha!

- Të tha gjëra të tilla tetoja?

- E përse habitesh? Pas pak kohe mbush shtatëmbëdhjetë vjeç! Dhe unë pyes veten, përse një grua nuk mund të ketë dy apo tre burra?

- Sepse atëherë... do të jetë një grua e ulët! Përderisa do ta dish!

- Po burri? Çfarë do të jetë burri?

- Burri do të jetë burrë!

- A e kuptove tani se përse them që të gjithë janë hipokritë? Për mua, burrë është ai që dashuron një grua dhe qëndron me të përgjithmonë. Vetëm një burrë të tillë ia vlen të dashuroj!

- Kjo që po thua nuk ekziston!

- Prandaj edhe unë nuk do të dashuroj kurrë!

- Theano, mos thuaj çmendurira dhe po më bën të shqetësohem!

- Dëgjo, Argjir, kohët e fundit jam menduar shumë... E di që një moment do të martohem, siç bëjnë të gjitha vajzat e mira që ne njohim... Por nëse burri im nuk do të jetë besnik, do ta zboj, dhe që të mund ta bëj këtë gjë, nuk duhet të jem e dashuruar marrëzisht me të, sepse atëherë do të kem frikë se mos e humbas. Dashuria, kushëriri im i dashur, të kthen në viktimë, dhe unë nuk kam lindur për t'u bërë viktimë! E kuptove tani?

Ishte në mëdyshje nëse Argjiri e kishte kuptuar, por për këtë, nuk mund të bënte asgjë... Kishte lindur burrë, nuk kishte faj...



Llambroja ishte njëzet e pesë vjeç kur e pa për herë të parë Theanonë në një ekskursion që kursi i katekizmit kishte organizuar në Tatavlla... Ishte bashkë me prindërit dhe xhaxhain e saj dhe atë ditë ajo ishte në humor. Kërceu dhe një vals me Argjirin, kështu që iu dha mundësia ta

sodiste në qetësi dhe i mrekulluar atë vajzë shtathedhur që ndiqte me hijeshi ritmin e valles. Binte në sy në mes vajzave të tjera që ishin në atë ekskursion. Pyeti me marifet për të dhe mblodhi të gjitha informatat që i duheshin. Ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe vinte nga një familje e mirë.

Mënyra se si do t'i afrohej ishte një problem i madh. Nuk dëshironte që të dërgonte ashtu rëndom një shkues. Dëshironte që më parë ta njihte.

Zgjidhja ishte Argjiri, dhe Llambroja bëri çmos për ta njohur, dhe ia arriti qëllimit. Argjiri nëntëmbëdhjetëvjeçar u miklua nga interesimi që tregonte për të një burrë njëzetepesëvjeçar dhe filloi të shkonte gjithandej me të. Hapi pasardhës do të ishte që t'i takonte të dy gjatë shetitjes që bënin në Pera dhe, natyrisht, Argjiri nuk kishte rrugë tjetër, do ta prezantonte me të.

Qëlloi me fat një muaj pas atij ekskursioni na Tatavlla. Një të diel pasdite, Theanoja me Argjirin po hanin akullore. Bashkë me ta ishte edhe Elisoja, por Llambroja nuk i kushtoi rëndësi. Sytë e tij shihnin vetëm Theanonë, e cila shkëlqente me atë fustan bojëqielli që kishte veshur atë ditë. U afrua te tavolina e tyre dhe Argjiri, sapo e pa, u ngrit i gëzuar.

- Llambro! Ç'ne këtej ti?

- Thashë të pija një kafe dhe të pashë ty!

U kthye dhe vështroi Theanonë, duke i dhënë Argjirit të kuptonte se po priste që ta prezantonte, gjë që Argjiri, i cili nuk dyshonte aspak, e bëri menjëherë.

- Më fal... t'ju prezantoj... Këto janë kushërirat e mia, Theano dhe Eliso Jumurtaxhi... Ndërsa ky është miku im, Llambro Kunduraxhi.

Theanoja ia zgjati dorën plot hijeshi, duke e vështuar në sy Llambro, i cili u skuq.

- Hajde, Llambro... Ulu me ne! - e ftoi gjithë qejf Argjiri dhe Llambroja nxitoi të ulej, sepse këmbët nuk po e mbanin më. Nga afër Theanoja iu duk edhe më e bukur, dhe zemra i rrahu kaq fort, saqë pati frikë se do ta dëgjonin të gjithë.

- Theano, Llambroja ka një dyqan afër Kapali Çarshisë, e di ku është... - ia bëri Argjiri.

- Ashtu? Dhe çfarë tregtoni, zoti Kunduraxhi? - e pyeti Theanoja, dhe Llambroja u kollit që të pastronte zërin para se të përgjigjej.

- Kam një dyqan kinkalerie, zonjushë... Kemi çdo gjë që mund t'ju shkojë nëpër mend... Por tani së fundmi mora edhe dyqanin në krah dhe e zmadhova... kam edhe penj për makinë qepëse si edhe lesh për thurje... Do të ishte kënaqësi për mua nëse do të vinit ndonjë ditë dhe t'ju shërbeja!

- Ju faleminderit... edhe mund të vij... me nënën time, natyrisht, për të blerë ndonjë gjë...

Dhe e bëri fakt që javën e ardhshme.

Llambroja, që po sistemonte disa turra leshi në raftet e reja, për pak sa nuk u rrëzua nga stoli kur e pa të hynte një mëngjes në dyqan, së bashku me një zonjë që i ngjante shumë dhe që ishte e ëma. Iu afrua dy grave i skuqur në fytyrë si panxhar.

- Mirëmëngjesi... - u tha me ndrojtje.

- Mirëmëngjesi, zoti Kunduraxhi! - iu përgjigj me guxim Theanoja, dhe pastaj u kthye nga e ëma, që po e shikonte e habitur. - Nënë, zoti Kunduraxhi është mik me Argjirin tonë.

Dhespina buzëqeshi dhe u kthye nga Llambroja, që po skuqej gjithnjë e më shumë.

- Domethënë, njiheni me nipin tim?

- P... po... Domethënë, jemi miq...

- E po atëherë, gëzohem shumë! Prandaj këmbëngulte vajza ime që të vinim te dyqani juaj, meqë na ra rruga këndeji!

Mundet që aty në dyqan Dhespina e justifikoi të bijën, por me të dalë jashtë, filloi nga pyetjet.

- Pra, na qenka mik i Argjirit djaloshi?

- E po, a nuk ta thashë?

- Po ti, nga e njeh?

- Uf, dhe ti nënë! Para pak ditësh ma prezantoi Argjiri në ëmbëltooren ku kishim vajtur së bashku me Alisonë.

- Dhe sot erdhëm dhe te dyqani i tij?

- Përderisa doja të blija gjithë ato gjëra!

- Të cilat deri më sot i blije në tjetër vend! Moj, mua do që të ma hedhësh? Theano, ki kujdes, nëse marr vesh ndonjë gjë, fije floku s'kam për të të lënë në kokë! Më thuaj: ç'po ndodh me këtë djalosh, zonjushë?

- Të betohem, asgjë nuk po ndodh!

- Por, a do të doje që të ndodhte?

- Kjo është diçka tjetër!

- E pra, për këtë gjënë tjetër dua dhe unë të di! Nëse do të të kërkonte, do ta merrje për burrë?

- Po ti, nga e di se ai më do?

- E... mirë tani! Nuk duhet ndonjë filozofi e madhe! Fakti që të dashuron, është e shkruar në gjithë fytyrën e tij. Po ti, e merr nëse ai të kërkon?

- Nuk e di!

- Ej! Përpiqu ta dish, se, siç e nuhata unë, nuk do të vonojë të dërgojë shkesin, dhe mbaje mend orën që ta thashë këtë.



Ashtu si gjithmonë, Dhespina kishte të drejtë. Dashuria e Llambros mori përmasa gjigante pas asaj vizite të shkurtër. Nuk mund ta largonte mendjen nga Theanoja për asnjë çast, gjithandej i shfaqej imazhi i saj... Përplasej me njerëzit në rrugë, pengohej vazhdimisht dhe bënte gabime edhe në punë. I dëshpëruar, bisedoi me prindërit e tij, të cilët, sigurisht, që kishin nuhatur diçka, por kur mësuan se për cilën vajzë bëhej fjalë, u entuziazmuan dhe nxituan të dërgonin Ortancian, një të njohur të të dyja palëve, për të folur në emër të tyre. Ortancia ishte lënëshë, dhe nga marazi që kishte mbetur e pamartuar, bënte mblesëritë e botës. Kështu që, kur njerëzit e shihnin tek futej në ndonjë shtëpi, e dinin që sillte lajmin për martesë dhe asgjë tjetër... Atë të diel pasdite, Dhespina nuk u habit aspak kur e pa te pragu i shtëpisë, përkundrazi, i buzëqeshi dhe i uroi mirëseardhjen. Por Josifi, veçse e humbi toruan. Herë shikonte nga e shoqja, që buzëqeshte në një mënyrë të çuditshme, dhe herë nga Ortancia, që gjithashtu buzëqeshte. Por, kur dëgjoji edhe arsyen e asaj vizite, atëherë e humbi krejtësisht.

- Ç'janë këto që po më thoni, zonjushë Ortancia? - e ngriti zërin ai. - Vajza ime është ende e vogël!

- Nuk është dhe aq e vogël, zoti Josif! Theanoja prej muajsh i mbushi tetëmbëdhjetë vjeç, apo e kam gabim?

- Jo, nuk e keni gabim. Por çfarë rëndësie ka kjo? Se duhet ta jap kështu, kush të dalë para?

- Përse e thoni këtë, zoti Josif? Llambroja është djalë i mirë dhe i zoti, ka dyqanin e tij dhe shumë pará. Si mbretëreshë do të jetojë Theanoja në krah të tij. Zonjë dhe

shkuar zonjës! Çfarë tjetër dëshironi ju? Të rinj janë, të bukur po, një çift i përkryer që janë bërë për njëri-tjetrin!

Josifi vështroi nga e shoqja me një pamje sikur po mbytej, dhe Dhespina mori përsipër ta sqaronte Ortancian.

- Zonjushë Ortancia, mos na keqkuptoni, por e kuptoni dhe vetë... na erdhi paksa e papritur... Prindërve, fëmijët e tyre u duken gjithnjë të vegjël dhe burri im harron se kur më kërkoi për nuse, kisha pak a shumë moshën e vajzës së tij!

- Ashtu është... e kuptoj... Por çfarë t'i them familjes Kunduraxhi?

- T'u thuash që propozimi i tyre është nder i madh për ne, por kërkojmë një a dy ditë kohë që ta mendojmë dhe pastaj të vendosim... A nuk është e arsyeshme kjo?

- Natyrisht! Pra, ju dëshironi që të kaloj të... mërkurën, le të themi?

- Do të ishte më e mira. Të mërkurën do të merrni dhe përgjigjen!

Kur dera u mbyll pas Ortancias, Dhespina, pa thënë asnjë fjalë, i vuri të shoqit përpara një gotë konjak dhe i solli dhe cigaret. Pa hapur gojën, Josifi e rrëkëlleu menjëherë konjakun dhe ndezi cigaren. Vështroi nga e shoqja që i buzëqeshte me nënkuptim.

- Të erdhi e papritur, burri im?

- Pse, ty nuk të erdhi?

- E po, jo edhe aq! Unë jam grua, i shoh ndryshe gjërat. Prej kohësh prisja të na vinte ndonjë shkes. Për më tepër, e dinim që kur ishte më e vogël, se me një bukuri të tillë, do të tërhiqte shpejt vëmendjen. Meqë ra fjala, u vonua paksa...

- Ç'po na thua, grua? Ajo është ende fëmijë.

- Ej, jo dhe aq! Dhe nëse do ta dish, ajo e ka njohur djaloshin Kunduraxhi!

- Mos më thuaj!

- Mos të të shkojë mendja për të keq! Është mik i Argjirit dhe u njohën një ditë që kishin dalë shëtitje, megjithëse unë e di që ai e kishte parë më përpara.

- Ku e kishte parë?

- Në ekskursionin që bëmë në Tatavlla!

- Theanoja t'i tha këto?

- As ajo vetë nuk dinte gjë në atë kohë. Vetëm se unë e pashë dhe kuptova. Nuk i shqiste sytë prej saj! Pastaj e takuan, gjoja rastësisht, por unë e kuptova se djaloshi bëri gjithçka që mundej për ta takuar.

- Po tani, çfarë do të bëjmë? Do t'ia japim atij?

- Besoj se për këtë duhet ta pyesim.

- Grua, u çmende? Si do ta pyes time bijë për diçka të tillë?

- Por jo ti, o i gjorë! Unë do ta pyes, por ta dish... përgatitu, se kemi dasmë!

Theanoja nuk dinte asgjë për të gjitha këto. Kishte shkuar së bashku me Uraninë te gjyshja e saj, por, sapo u kthye, diçka nuk i pëlqeu në fytyrën e të atit. Madje, sapo hyri, ai doli menjëherë, dhe Theanoja pyeti të ëmën:

- Çfarë ka babai?

- I ra tavani në kokë dhe ende nuk e ka marrë veten, - iu përgjigj e qetë e ëma.

- Po tallesh? Nododhi diçka gjatë kohës që nuk isha?

- Kishim vizitorë!

- Ashtu? E kush erdhi?

- Ortancia!

Theanoja u zbeh.

- Ajo e mblesërive?

- Ajo!

- E çfarë donte?
- Sigurisht, jo për të bërë ndonjë mblesëri për Elisonë!
- Aman, mos ma thuaj, se do të më bjerë të fikët! Është ajo që mendoj unë?
- Po! Zoti Llambro Kunduraxhi na kërkon dorën tënde! Theanoja u shemb në një karrige.
- Po ju, çfarë i thatë? - pyeti duke iu marrë fryma.
- Çfarë doje ti që t'i thoshim? Kështu, duke qenë mirë e bukur, t'i urojmë mirëseardhjen dhëndrit? I thamë që të na jepte dy ditë afat që ta mendojmë pak!
- Po babai çfarë tha? Si e priti?
- Të thashë: i ra tavani në kokë! Në fillim për pak sa nuk e flaku jashtë!
- Aman! Po pastaj?
- Pastaj... me takt i kujtova se edhe unë në këtë moshë isha kur më kërkoi për grua dhe sikur u qetësua, por akoma nuk e ka kapërdirë. Ma lër mua tët atë dhe më thuaj, ti çfarë do!
- Për Llambbron?
- Pse, ka dhe ndonjë tjetër?
- Ç' thua, moj nënë? Kush tjetër? Sigurisht që për Llambbron e kam fjalën! Po ti çfarë do të bëje po të ishe në vendin tim!
- E po nuk jam në vendin tënd!
- Nuk po më ndihmon!
- Është çështje e tillë që nuk mund të të ndihmoj. E do atë djalë?
- Nuk them... më pëlqen ... i bukur është, punë të mirë ka... por nuk e dashuroj...
- Do ta dashurosh pas martese, ashtu si i dashuruam të gjitha ne burrat tanë!

- Por nëse kjo nuk do të ndodhë me mua?

- Ç'janë këto budallallëqe që rri e më thua? Si nuk do të dashurosh burrin tënd dhe babanë e fëmijëve të tu nesër, pasnesër? Bëhen këto gjëra? Nëse të pëlqen, ta marrësh!

- Mirë, por si do ta di nëse do të dalë njeri i mirë?

- Moj, të ka ikur mendja sot fare, këtë desha të di!

- Po pse, moj nënë? A nuk thotë gjyshja: "Njeriun e sheh, por zemrën nuk ia di"? Pastaj, a e mban mend se çfarë i ndodhi teze Titikës?

- E shoh që sot do të më çmendësh, bija ime! Moj, a e do, po apo jo?

- E... e dua!

- Lavdi Zotit! Më në fund!

Ortancia mori përgjigjen që priste dhe rendi e gëzuar t'ia përcillte Llambros, i cili mezi qëndronte në këmbë prej ankthit. Së bashku me përgjigjen pozitive, familja Jumurtaxhi kishte nderin ta ftonte së bashku me prindërit e tij, në shtëpinë e saj të dielën e parë të majit, në mënyrë që të jepej përgjigjja edhe në formë zyrtare. Si një ëndërr i dukej Llambros, i cili numëronte jo vetëm ditët, por edhe orët.

Porsi një ëndërr i dukej edhe Theanosë. Më së fundi, një e çarë e vogël në kafazin ku ishte mbyllur... Tashmë e ëma sillej krejt ndryshe me të, e trajtonte pothuajse si të barabartë, dhe kjo gjë në fillim e habiti tej mase. Pothuajse e humbi toruan kur Dhespina i kërkoi mendim për gjellët që do të përgatiste për ditën e vizitës. Natyrisht, i ati nuk e kishte hapur fare si bisedë, thua se nuk kishte ndodhur asgjë, thua se asgjë nuk kishte për të ndodhur. Madje, edhe ditën që do të vinin për vizitë, kur u ulën në tavolinë për drekë, nuk mundi as që ta uronte. Theanoja në fillim u habit,

por pastaj kuptoi se kjo ishte një goditje tjetër për të. I ati i saj kishte turp! Më shumë se edhe vetë ajo...



Dhëndri me prindërit e tij do të vinin në orën shtatë, por Theanoja ishte bërë gati që në orën gjashtë dhe inspektonte shtëpinë, ndërsa e ëma dhe tetoja, bënë potere në kuzhinë ku ishin futur që në mëngjes. Urania kishte fluturuar nga gëzimi për fatin e mbesës së saj dhe, natyrisht, dinte çdo gjë për dhëndrin dhe familjen e tij, me kaq imtësi, sa që Dhespina, duke u shkriur së qeshuri, arriti t'i thoshte: “Zoti të të ruajë, Urani! Ti dhe shkuesja i dini të gjitha këto!”.

Theanoja buzëqeshi përsëri teksa dëgjoi teton e saj nga kuzhina duke thirrur:

- Moj Dhespina, më jep diçka ku të vendos byreçkat! Dhe nënën e saj teksa i përgjigjej:

- Përbri e ke pjatancën, të marrtë e mira! Më lër, se më duket se hodha më tepër limon te supa!

Theanoja drejtoi një rrudhë te çentroja e bufesë, i hodhi një vështrim të fundit dhomës së pritjes dhe pastaj shkoi në kuzhinë.

Sapo e pa, tetoja filloi t'i bërtasë:

- Ç'punë ke ti këtu, në një ditë të tillë? Dhe pastaj, duke e ngritur më tepër zërin: - Theano, mos u mbështet asgjëkund, do të bëhesh pis!

- Mos bëj kështu, teto! Më ngrive gjakun! - reagoi Theanoja, e cila u tremb se nuk e pati mendjen.

- Gjaku do të të ngrijë nëse bën pis fustanin në momentin e fundit. Shko në dhomë dhe pas pak vijmë edhe ne. Mbaruam këtu. Se mos vijmë krushqit dhe na gjejmë në kuzhinë!

Theanoja u bind. U kthye në dhomën e pritjes dhe qëndroi afër dritares, duke vështruar nga rruga. Si një diçka ireale i dukej kjo e sotmja. Që të nesërmen, ajo dhe Llambroja do të konsideroheshin të fejuar, por nuk e dinte nëse ndiente diçka mbresëlënëse në lidhje me këtë... Ishin parë edhe dy herë të tjera që atë ditë në dyqanin e tij. Hera e parë ishte në Pera, teksa shëtisnin. Ishte bashkë me prindërit e saj dhe Llambroja, të vetmen gjë që guxoi të bënte, ishte të hiqte kapelën dhe të përshëndeste Josifin dhe Dhespinën i skuqur flakë në fytyrë, pa guxuar t'i hidhte asnjë vështrim asaj. Herën e dytë, ai qe më me fat, aq sa edhe vetë nuk donte ta besonte... Theanoja po shkonte te shtëpia e Marikës për provë kur u takuan. Mbetën të dy si të ngrirë në mes të rrugës.

- Mirëmëngjesi... - belbëzoi i pari ai dhe Theanoja i buzëqeshi.

- Mirëmëngjesi...

- Si... si jeni?

- Mirë... po ju?

- Edhe unë, mirë... Ku... ku po shkoni që në mëngjes?

- Te një kliente për provë... Po përse më flisni në shumës? Pas pak ditësh do të presim fjalën!

Llambroja e vështroi për herë të parë në sy dhe mori frymë thellë.

- Ke të drejtë... - i tha. - Dhe të mendosh që unë, si burrë, duhej të kisha më tepër guxim!

- Nuk ka të bëjë kjo... Por më duket paksa e çuditshme që po flasim si të huaj, përderisa do të martohemi. A nuk është kështu?

- Ke të drejtë... Theano... doja të dije që... unë domethënë... ajo që dua të të them...

- Llambro! - e ndërpreu në mënyrë të rreptë ajo. - Nëse çdo herë që do të më flasësh, do të humbasësh fillin e bisedës, nuk do të mund të merremi vesh!

- Përsëri ke të drejtë, por nuk e di se çfarë më ndodh kur të vështroj!

- E po mirë atëherë, vështro diku gjetkë, mjafton që të më flasësh pa e humbur toruan!

- Të dashuroj! - ia bëri ai papritur, dhe Theanoja buzëqeshi.

- Kjo ishte e gjitha? - ia ktheu në mënyrë lozonjare. - Dhe unë kujtoja se doje të më thoshe diçka më të vështirë!

Tani po i buzëqeshte edhe ai.

- Po bëj si fëmijë i vogël, apo jo? - e pyeti.

- Ndoshta... dhe je edhe njëzet e pesë vjeç burrë! E pra, e di që më dashuron, përndryshe nuk do të më kërkoje për grua. Por unë, veçse nuk të dashuroj!

- Nuk më dashuron? Po atëherë, pse pranove?

- Ore Llambro, pa mendohu pak! Unë pothuajse nuk të njoh, si mund të të dashuroj? Por kam simpati për ty, më pëlqen, prandaj thashë “po”. E kuptove tani?

- Por a do më dashurosh?

- As këtë nuk e di. Gjyshja ime thotë se një njeri e dashuron, kur ai e meriton. Pra, nëse do ta meritosh... Do të shohim...

- E dija që ishe e veçantë, ndryshe nga vajzat e tjera. Asnjëra nuk do të fliste në këtë mënyrë. Asnjëra! Prandaj të dua akoma më shumë!

- Tani më duhet të iki... kemi shumë që po flasim dhe do të biem në sy... Supozohet se jemi ende dy të huaj... Pra, të dielën tjetër...

- Po... Të dielën tjetër...

Dhe kjo e diela tjetër kishte ardhur, ndërsa ajo po kërkonte të gjente se çfarë ndiente...

E vërteta është se Llambro i pëlqente paksa. Kishte diçka në sytë e tij që e tërhiqte shumë... Ata sy kishin një ëmbëlsi që asaj i pëlqente... Dhe e dashuronte... Këtë, madje, mund ta kuptonte edhe ajo që ishte pa eksperiencë, nga mënyra se si ndryshonte vështrimi i tij kur binte mbi të. Pyeti veten se si do të ndihej kur ai do ta puthte dhe i erdhi turp nga vetja për këto mendime, por nuk mund të injoronte drithërimën që ndjeu t'i përshkonte gjithë shtyllën kurrizore.

Babai i saj, së bashku me xhaxhain dhe Argjirin u futën në shtëpi në po atë çast kur e ëma dhe Urania po dilnin nga kuzhina.

- Mbaruat me përgatitjet? - pyeti Josifi të shoqen.

- Gjithçka është gati! Tani nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të presim dhëndrin, - iu përgjigj Dhespina.



Tingëllima e ziles u dëgjua qartë, kur akrepat e orës tregonin orën shtatë fiks. Të gjithë vështruan njëri-tjetrin dhe tek ai vështrim ndihej njëfarë pasigurie. Momenti kishte ardhur, dhe gjërat u bënë edhe më të vështira, të paktën gjatë orës së parë të vizitës. Për fat të mirë, Urania dhe Theofili i njihnin paksa Kunduraxhinjtë dhe e mbanin ata bisedën të gjallë, ndërsa Dhespina bënte përpjekje të mëdha që të zëvendësonte disi të shoqin, që nuk po hapte gojën.

Argjiri, nga ana e tij, bënte çdo gjë që mundej, në mënyrë që Llambroja të ndihej më i lehtësuar, sepse dallohej që ishte në siklet. Theanoja nxori glikonë së bashku me të ëmën për t'u uruar mirëseardhjen, dhe kur i erdhi radha

të qeraste Llambbron, shkëmbeu me të një vështrim, pasi askush nuk mund ta shihte. Madje arriti t'ia bënte edhe me sy për ta inkurajuar, dhe pikërisht për këtë ai kishte nevojë që t'i përmirësohej humori.

Po afrohej ora për t'u ulur në tavolinë dhe Theofili u ngrit për t'i dhënë zgjidhje ngërçit që ishte krijuar nga hutimi.

- E, pra, zonja Ana, - iu drejtua ai së ëmës së Llambros, - besoj se nuk kemi ardhur vetëm për t'u argëtuar sonte! Diçka ke në çantën tënde për mbesën time! Do t'ia japësh, apo djali yt ndërroi mendje?

Gruaja buzëqeshi e lehtësuar, u ngrit, hapi çantën e saj, nxori andej një kuti dhe iu afrua nuses. Llambroja vajti menjëherë në krah të saj, teksa e ëma po kalonte në qafën e Theanosë një kryq të rëndë me diamante. E puthi kryqas, i dha bekimin e saj dhe në vazhdim e uruan të gjithë të tjerët. I fundit mbeti Llambroja që po e vështronte me adhurim. Nxori nga xhepi një kuti të vogël.

- Kryqin e ke prej prindërve të mi, për të të thënë se të mirëpresin si bijën e tyre... por kjo, ama, është besa ime, se do të të dua dhe do të të nderoj përgjithmonë...

I kaloi në gisht një unazë me një gur të kuq në formë zemre përsipër, dhe pastaj, pa u ngutur dhe me devocion, sikur po falej para një ikone, e puthi në ballë...

Ishte hera e parë që e prekte Llambroja dhe Theanoja ndjeu një drithërimë të ëmbël ta përshkonte. Ngriti kokën dhe e vështroi, dhe ai u elektrizua prej vështrimit të saj. Mbetën në këmbë duke u vështruar para të gjithëve dhe do të qëndronin ashtu për shumë kohë akoma, nëse zëri i Dhespinës, i butë dhe i emocionuar, nuk do t'i nxirrte nga ajo gjendje e magjishme.

- E po... besoj se erdhi koha për t'u ulur në tavolinë...

U ngritën të gjithë për të kaluar në tavolinën e stolisur të ngrënies dhe koha në vazhdim kaloi në një atmosferë hareje, urimesh dhe të qeshurash. Për fejesën ranë dakord gjatë kohës që po pinin kafënë. Do të bëhej pas një muaji në hotelin *Kervan Sarai* në *Taksim* dhe do të kishte shumë të ftuar.

Jeta e Theanosë ndryshoi shumë pas asaj dite. Punët iu shtuan. I duhej të përgatitej për fejesën, të qepte fustanin e saj, të kujdesej për çdo hollësi, por, çfarëdo që bënte, atë që nuk mund të harronte, ishte puthja që i kishte dhënë Llambroja në ballë, ditën kur prenë fjalën.

Nuk kishin mbetur kurrë vetëm të dy që atëherë dhe Theanoja pyeste veten se cili do të ishte vazhdimi. Kishte filluar të ndihej paksa e zhgënjyer nga fakti që Llambroja nuk ishte përpjekur të mbeteshin qoftë edhe pak minuta vetëm gjatë gjithë atij muaji që i parapriu fejesës, por zemërohej edhe me të tjerët që nuk i linin rehat asnjë çast. Të vetmet momente intimiteti që u lejoheshin, ishin gjatë shëtitjes, kur mund të ecnin të zënë përkrahu, por kjo asaj nuk i mjaftonte. Pyeste veten sesi do të ndihej kur Llambroja do ta puthte.

Tri ditë para ceremonisë së fejesës, ai erdhi pasdite në shtëpinë e tyre dhe e ëma e saj e mbajti për darkë. Në orën dhjetë, kur ai u ngrit për të ikur, e ëma e urdhëroi:

- Theano, shoqëroje Llambbron! Do ta lësh të largohet i pashoqëruar?

Theanoja e vështroi e habitur, teksa ishte hera e parë që e ëma i jepte shansin të mbetej vetëm për vetëm me të, por në vështrimin e Dhespinës ajo nuk dalloi asgjë të veçantë. Dolën së bashku me Llambbron dhe zbritën shkallët e ngushta që të çonin te dera e jashtme. Ndaluan para derës

se drunjtë, por Theanoja nuk e hapi. Vështroi Llambron, frymëmarrja e të cilit, papritmas u bë më e shpeshtë.

- Për atë Zot, Theano, mos më vështro në atë mënyrë... - i tha.

- Pse?

- Sepse as vetë nuk e di sesi po përmbahem gjatë gjithë këtyre javëve!

- Për çfarë përmbahesh? Nuk po të kuptoj!

- Prandaj po të them! Hape derën të iki... është më mirë kështu...

- Nuk dëshiron të qëndrojmë për pak vetëm?

Llambroja e vështroi dhe pastaj zgjati dorën dhe i përkëdheli flokët.

- Ta dish se të dashuroj jashtë mase... - foli ai ngadalë.

- Dakord, por kaluan kaq javë dhe nuk e ke treguar... - u ankua ajo. - Pothuajse më shmangesh!

- Sepse nuk dua të bëj diçka që mund të të ofendojë!

- E çfarë mund të bëje që do të më ofendonte mua? A nuk je i fejuari im?

Llambroja psherëtiu. Theanoja, në atë moment, pa e ditur as vetë, ishte shumë provokuese, me sytë që i shkëlqenin prej pasionit dhe buzët gjysmë të hapura duke pritur atë që edhe vetë ai dëshironte të bënte që ditën kur e kishte parë për herë të parë. E përqafoi me shumë ëmbëlsi dhe preku butësisht buzët e saj me të tijat. Ajo që nuk priste, ishte reagimi i Theanosë. I kaloi duart përreth tij dhe e shtrëngoi me pasion. Llambroja, më së fundi e la veten të lirë dhe i habitur konstatoi se Theanoja reagonte pa ndrojtje... Buzët i kishin të skuqura dhe të dy merrnin frymë me vështirësi kur ai e lëshoi.

- Këtë gjë po përpiqesha të shmangia... - i tha sapo e mori veten dhe mundi që të fliste.

- E përse doje që ta shmangie? - e pyeti ajo, duke rregulluar nxitimthi flokët.

- Sepse akoma nuk jemi as të fejuar!

- Po pastaj? Fejesën do e bëjmë pasnesër dhe, siç dëgjove, deri për Krishtlindje do të kemi bërë dhe dasmën. Pra, nga çfarë ke frikë?

- Nuk kam frikë për vete, por për ty... Nuk e prisja që...

- Që të doja të më puthje?

- Edhe kjo, por dhe mënyra...

- Mënyra se si të putha edhe unë? Do të preferoje të qëndroja si e ngrirë apo të të qortoja ngaqë më ofendove? Por, a nuk e kupton se atë që dëshiron ti, atë që ndien ti, të njëjtën gjë mund të ndiej edhe unë? Me një fjalë, duhet të jesh burrë, që të kesh këtë dëshirë?

- Je ndryshe nga vajzat e tjera, Theano...

- Këtë ma ke thënë edhe herë tjetër dhe e ke pranuar se për këtë të pëlqeva!

Llambro i buzëqeshi dhe vetëtimthi e puthi në buzë, por u tërhoq menjëherë.

- Mjaft për sot! - i tha me një ton të rreptë gjoja. - Nuk mendoj se prindërit e tu do të gëzohen nëse të shohin që po ngjitesh e çorientuar dhe me buzët të ënjtura nga puthjet!

- Për këtë ke të drejtë, - pranoi ajo, dhe në zërin e saj ndihej njëfarë mërziçjeje.

Sigurisht që Theanoja nuk e dinte që në atë moment e ëma po përpiquej ta mbronte para të shoqit.

- Sikur u vonua shumë Theanoja që të ngjitet? - pyeti Josifi pasi kishin kaluar pesë minuta që kur kishin dalë dy të fejuarit.

- Eh, mos e quaj dhe vonesë, de! Pastaj, lëri që të rrinë edhe pak vetëm, - iu përgjigj e qetë Dhespina.

- Ç'kanë për të thënë vetëm, domethënë? Ato që kanë për të thënë i thonë gjatë shëtitjeve çdo të diel, kur ecin dorë për dorë!

- Por nuk duan të flasin, Josif! Të veprojnë duan!

- E çfarë duan të bëjnë, pa ma shpjego!

- Ato që bënim edhe ne kur ti përdorje një mijë e një marifete, që të mbeteshim vetëm, nën hundën e familjarëve të mi. Uf, edhe ti Josif! Të fejuar janë, të rinj janë... Ç'kërkon ti të bëjnë?

- Moj grua, u çmende? Këto janë gjëra të turpshme!

- Mirë, pra, po ti përse i bëje? Josif, e harrove se ç'do të thotë të jesh i ri në moshë? I ri dhe i dashuruar?

- Mirë, mirë, por tani bëhet fjalë për vajzën tonë!

- Dha vajza jonë është e re në moshë dhe pas pak kohe do të martohet. Pastaj, nga se ke frikë? Para derës do të jenë, duke u puthur!

- Këtë gjë unë nuk e lejoj! - ia bëri Josifi dhe përplasi fort dorën në tryezë. - Dhe ta dish, ti e ke fajin! Ti e dërgove që ta përcillte!

- Po pikërisht për këtë e dërgova!

- Për ta puthur ai i... i paudhi?

- Ai i paudhi, siç po e quan ti, tashmë është dhëndri yt! Edhe do ta përqafojë, edhe do ta puthë, edhe... fëmijë do të bëjë me të më vonë. Hajde, mblidhe pak mendjen, Josif! Vajza jote tashmë është grua!

- Po, por, më duket sikur nuk ishte më larg se dje koha kur ajo ishte vajza jonë e vogël!

- Por tani, ajo është e Llambros! Dhe ki mendjen se mos i bësh ndonjë vërejtje tani që do të ngjitet, sepse nuk të flas më me gojë, ta dish! Do të sillesh sikur nuk ka ndodhur gjë!